USHTRIA

Viti i 68-të i botimit Nr. 51 (8252) | Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes | E premte, 26 dhjetor 2014

TAKIM MBRESËLËNËS ME FËMIJËT NË PRAG TË VITIT TË RI

Me rastin e festave të fundvitit në Qendrën e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes, Muzeut dhe Shtëpive të Pushimit u zhvillua një ceremoni festive me fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës dhe fëmijët e ushtarakëve që shërbejnë në misione paqeje jashtë atdheut. Në këtë ceremoni ishte i pranishëm: kryeministri i Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, ministri i Brendshëm, z. Saimir Tahiri, fëmijë dhe pjesëtarë të familjeve të policëve të vrarë në krye të detyrës, të ushtarakëve që shërbejnë në misione paqeje jashtë atdheut, ushtarakë dhe policë në detyrë etj.

Fjalën e hapjes e mbajti ministrja e Mbrojtjes Kodheli, e cila midis të tjerave theksoi se, në radhë të parë dua të përshëndes trupat tona që ndodhen në mision jashtë vendit, sidomos fëmijët e tyre të mrekullueshëm...

» faqe 2

Gazeta "Ushtria" iu uron ushtarakëve dhe punonjësve civilë të FA: Gëzuar Vitin e Ri 2015!

ANALIZAT VJETORE

FT, në krye të detyrave për plotësimin me nder të misionit kushtetues

KDS, motoja e punës për vitin 2015 do të jetë: Performancë-Cilësi-Reformë

» faqe 4-6

Pragfestat

Koncert artistik për fëmijët e ushtarakëve të Forcave të Armatosura

Në vigjilje të festave të fundvitit, Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri, Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes, Muzeut dhe Shtëpive të Pushimit (QKMBMMSHP) organizoi në sallën e kinemasë së garnizonit "Skënderbej" një koncert artistik...

» faqe 3

Stërvitje

Ditë plot ngarkesë dhe stërvitje në Forcën Tokësore

Në këto ditë të fundvitit tek efektivat e njësive dhe reparteve të Forcës Tokësore ndjehet një frymë më e lartë mobilizimi dhe përkushtimi për të përmbushur të gjitha detyrat dhe objektivat e përcaktuara. Bilanci është i pasur, arritjet janë të...

» faqe 8

INTERVISTA

Luiza Gega, atlete e mirënjohur dhe përfaqësuese e denjë e FA

» faqe 9

DOSSIER

UNÇL Shqiptare për çlirimin e Kosovës dhe popujve të ish-Jugosllavisë gjatë LIIB

faqe 12-13

NATO

Samiti i vitit 1990: pikë kthese në marrëdhëniet "Lindje- Perëndim"

faqe 14

Me fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës dhe ushtarakëve që shërbejnë në misione jashtë atdheut

Takim mbresëlënës me fëmijët në prag të Vitit të Ri

Kodheli: Ne nuk duhet të rreshtim së punuari për rritjen dhe edukimin e fëmijëve tanë, për tu dhënë atyre dinjitetin që u takon, të ardhmen që meritojnë, atë europiane

Me rastin e festave të fundvitit në Qendrën e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes, Muzeut dhe Shtëpive të Pushimit u zhvillua një ceremoni festive me fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës dhe fëmijët e ushtarakëve që shërbejnë në misione paqeje jashtë atdheut. Në këtë ceremoni ishte i pranishëm: kryeministri i Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, ministri i Brendshëm, z. Saimir Tahiri, fëmijë dhe pjesëtarë të familjeve të policëve të vrarë në krye të detyrës, të ushtarakëve që shërbejnë në misione paqeje jashtë atdheut, ushtarakë dhe policë në detyrë etj.

Fjalën e hapjes e mbajti ministrja e Mbrojtjes Kodheli, e cila midis të tjerave theksoi se, në radhë të parë dua të përshëndes trupat tona që ndodhen në mision jashtë vendit, sidomos fëmijët e tyre të mrekullueshëm, që kanë mbushur me ngrohtësi këtë sallë. Organizimi i këtij aktiviteti të sotëm, vijoi më pas ajo, përpos simbolikës së dhënies së dhuratave, ka për qëllim të përçoi tek ju një falënderim të veçantë, për FA në përgjithësi, për ata bijë dhe bija që i shërbejnë atdheut dhe Aleancës në misione paqeje kudo në botë. Prezenca e personelit të FA, që sot ndodhet në Afganistan, në Kosovë, Bosnje dhe nesër diku tjetër, dëshmon edhe njëherë se përpjekjet tona për paqen, mirëkuptimin, dashurinë dhe prosperitetin shtrihen edhe përtej kufijve të Shqipërisë. Më tej, ministrja Kodheli nënvizoi se, ne nuk duhet të rreshtim së punuari për rritjen dhe edukimin e fëmijëve tanë, për tu dhënë atyre dinjitetin që u takon, të ardhmen që meritojnë, atë europiane. "Më lejoni edhe njëherë të theksoj se unë si ministër i Mbrojtjes dhe qeveria shqiptare do të jenë pranë jush aty ku ndodheni, aty ku i bëni nder Shqipërisë, si dhe në krah të familjarëve tuaj këtu në Shqipëri. Ne ju detyrohemi, atdheu ju detyrohet", - ka përfunduar fjalën e saj ministrja Kodheli. Në përshëndetjen e tij kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama, ndër të tjera, theksoi se, kjo ditë është një ndër ditët që ne tregojmë dhe do të tregojmë kujdes për fëmijët e policëve të vrarë dhe fëmijët e ushtarakëve me misione paqeje kudo në botë. Qeveria jonë e ka bërë prezent se jo vetëm do tu gjendet, por do të ofrojë arsimim e punësim pa konkurs për të gjithë fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës dhe kjo jo se i shmangim nga konkurrimi i ndershëm, por se ata kanë një motiv më shumë për të qenë më të ndershëm, më të aftë, më të sakrificës. Qeveria jonë ka përmbushur shumë angazhime ndaj policëve dhe ushtarakëve që janë në misione paqeje, si në drejtim të pensionit, pagesës, por edhe të shërbimeve spitalore falas, pasi ata e meritojnë, sepse na nderojnë kudo në botë. Ndaj fëmijëve të policëve të vrarë në krye të detyrës ne kemi obligim të dyfishtë si për edukimin, po ashtu dhe për mbështetjen në çdo drejtim, pasi ata sot janë pa prindër dhe duhet të ndjejnë afër dorën e shtetit, dorën e qeverisë, dorën e shoqërisë, të cilën ne nuk do ta kursejmë në vazhdimësi, - përfundoi fjalën e tij kryeministri Rama.

Në këtë ceremoni përshëndeti edhe ministri i Brendshëm, z. Saimir Tahiri, i cili e vuri theksin në punën e bërë nga Policia e Shtetit në shërbim të rendit, qetësisë dhe sigurisë në vend.



Fëmijët janë shpresa jonë, e ardhmja jonë

Fjala e ministres së Mbrojtjes, Mimi Kodheli

I nderuar z. Kryeministër,
I nderuar ministri Tahiri,
Të nderuar ushtarakë, policë, oficerë, prindër, miq dhe të ftuar.

Në radhë të parë dua të përshëndes trupat tona që ndodhen në mision jashtë vendit, sidomos fëmijët e tyre të mrekullueshëm, që kanë mbushur me ngrohtësi këtë sallë. Uroj që ky prag festash t'i gjejë të shëndetshëm dhe të lumtur, por dhe e ardhmja e tyre të jetë sa më e paqtë, por aq dhe e begatë. Organizimi i këtij aktiviteti të sotëm, përpos simbolikës së dhënies së dhuratave, ka për qëllim të përçoi tek ju një falënderim të veçantë për Forcat e Armatosura në përgjithësi, për ata bijë dhe bija që i shërbejnë atdheut dhe Aleancës në misione paqeje kudo në botë. Ata burra dhe gra, që janë shëmbëlltyra më e dukshme e një Shqipërie dinjitoze dhe të angazhuar për paqe dhe sigurie kudo në botë. Jemi krenar për ju, ju jeni ambasadorët më të mirë të lirisë. Ndonjëherë natyra njerëzore bën që në ceremonitë zyrtare të ketë një qasje formale. Ju lutem sot, më shumë se kurrë, në prani të brezave dhe të së ardhmes sonë jam thjeshtë një bashkëqytetare juaja, kolege, por mbi të gjitha një prind dhe një nënë. Jam më se e sigurt se në kohët që jetojmë, në të përditshmen tonë, shpesh herë ndeshemi me vështirësi, si dhe problematika të ndryshme. Të gjithë ne si prindër dëshirojmë dhe mendojmë për më të mirën për familjet tona dhe kjo është më se normale për një shoqëri të shëndetshme. Prindërit tanë kanë bërë të njëjtën gjë me ne dhe ne do të vazhdojmë ta bëjmë për fëmijët tanë, për brezat që vijnë. Por prezenca e personelit të Forcave tona të Armatosura, që sot ndodhet në Afganistan, në Kosovë, Bosnje dhe nesër diku tjetër, dëshmon edhe njëherë se përpjekjet tona për paqen, mirëkuptimin, dashurinë dhe prosperitetin shtrihen edhe përtej kufijve të Shqipërisë. Ata po tregojnë se të ndërtosh një të ardhme, të pacenueshme për fëmijët tanë, duhet dhe bota që na rrethon të jetë sa e lirë, po aq dhe e sigurt.

Zonja dhe zotërinj,

Ne nuk duhet të rreshtim së punuari për rritjen dhe edukimin e fëmijëve tanë, për tu dhënë atyre dinjitetin që u takon, të ardhmen që meritojnë, atë europiane. E nesërmja e atdheut tonë varet nga këmbëngulja jonë për të forcuar mirëqenien dhe prosperitetin, si dhe aftësia jonë për të përçuar me dinjitet dije dhe dashuri për brezat e ardhshëm. Ne duhet të jemi aty për ata, por dhe kudo. Le t'i përqafojmë, le t'i vlerësojmë, le t'i japim siguri, le t'i falim dashuri të gjithë fëmijëve tanë, ata që janë këtu dhe ata që na ndjekin nëpërmjet medias vizive, kudo që janë. Fëmijët janë shpresa jonë e vetme, ne jemi shpresa e vetme për të tashmen dhe për të ardhmen, ndaj duhet të punojmë fort për të. Më lejoni edhe njëherë të theksoj se unë si ministër i Mbrojtjes dhe qeveria shqiptare do të jenë pranë jush aty ku ndodheni, aty ku i bëni nder Shqipërisë, si dhe në krah të familjarëve tuaj këtu në Shqipëri. Ne ju detyrohemi, Atdheu ju detyrohet.

Ushtarakë, prindër dhe fëmijë, gëzuar dhe për shumë vjet festat e fundvitit! Paçi shëndet, begati dhe lumturi në familjet tuaja! Qofshi gjithmonë të lumtur ju shoqëria e gjeneratës tjetër shqiptare!

Ju faleminderit të gjithëve, urime!

STAFI

Kryeredaktor: Muharrem **DARDHA**

Gazetarë: Mimoza **GOLIKJA**, Albert **ZHOLI**

Gazetarë: Saimir **ALIJA**, Etleva **SMAÇI**

Graphic Designer: Afërdita **HYSAJ**

ADRESA: **Ministria e Mbrojtjes, Bulevardi "Zhan D'Ark"**

Një urë "Bejli" për 3000 banorë të komunës së Kushovës, Gramsh

Ministrija e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli dhe ministri i Energjetikës, z.Damian Gjiknuri inauguruan përfundimin e punimeve të një ure Bejli në komunën Kushovë të Gramshit. Ura e ndërtuar nga Forcat e Armatosura në kuadër të bashkëpunimit civilo-ushtarak, i shërben katër fshtrave të komunës Kushovë dhe gjashtë fshtarave të Beratit, duke u ardhur në ndihmë mbi 3000 banorve të kësaj zone të thellë dhe të vështirë të vendit. Kryetari i komunës Kushove. z.Xhevahir Bora, falënderoi dy ministrat për angazhimin personal dhe reagimin e mënjëhershëm për t'i ardhur në ndihmë komunitetit të kësaj zone. Ai nënvizoi se ndërtimi i kësaj ure është i një rëndësie të madhe pasi lehtëson maksimalisht jetesën në këtë zonë.

Ministrja e Mbrojtjes Kodheli, pasi u njoh më rrugën shumë të vështirë që bënin banorët për të komunikuar mes tyre deklaroi se Forcat e Armatosura dhe lidershipi i tyre do të jenë prezente sa herë që do të ketë nevojë komuniteti. Gjithashtu ajo u shpreh se që sot fëmijët e këyre fshtarave nuk do të rrezikohen më duke kaluar në lumë për të shkuar në shkollë, por do të kalojnë të sigurt mbi këtë urë që ndërtuam për të komunikuar të gjithë banorët e kësaj zone të vështirë. Ndërsa ministri i Energjetikës Gjiknuri ka falënderuar ministren e Mbrojtjes Kodheli dhe Forcat e Armatosura për ndërtimin e kësaj ure dhe siguroi se qeveria do të vazhdojë të mbështesë me projekte komunitetin e Gramshit, i cili për vite ka qenë i harruar nga qeverisja e mëparshme.

Në fund të ceremonisë, ministria Kodheli u nderua me titullin "Nderi i komunës Kushovë'' me motivacionin "Për përmirësimin e infrastrukrës në kumunën Kushovë''. Po me këtë titull u nderua edhe komandanti i Komandës së Mbështetjes, gjeneral brigade Ylber Dogjani, i cili drejtoi punimet për ndërtimin e kësaj ure.

Në këtë festë të bukur të fëmijëve të ushtarakëve ishte i pranishëm shefi i SHP të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo

Koncert artistik për fëmijët e ushtarakëve të Forcave të Armatosura

Në vigjilje të festave të fundvitit, Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri, Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes, Muzeut dhe Shtëpive të Pushimit (QKMBMMSHP) organizoi në sallën e kinemasë së garnizonit "Skënderbej" një koncert artistik me fëmijët e ushtarakëve dhe të punonjësve civilë të FA-së. Në këtë festë të bukur të fëmijëve të ushtarakëve ishin të pranishëm, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, drejtori i Kabinetit të ministrit të Mbrojtjes, z Gjergj Teneqexhiu, drejtoresha e Përgjithshme e QKMBMMSHP, znj. Mirela Roshi, drejtues të tjerë të strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, fëmijë, prindër dhe familjarë të tyre etj.

Në fjalën e saj të hapjes të kësaj veprimtarie festive, znj. Mirela Roshi, pasi falënderoi pjesëmarrësit në koncert, tha se këta fëmijë, falë kujdesit të Ministrisë së Mbrojtjes, kanë privilegjin që përveç angazhimit në shkollë të ndjekin edhe kurse të ndryshme trajnimi pranë Qendrës së Kulturës të Forcave të Armatosura. Fëmijët e ushtarakëve që ndjekin këto kurse gjatë gjithë vitit janë të shumtë. Ata vijnë dhe trajnohen me plot dëshirë, për të zhvilluar më tej talentin e tyre, në fusha të ndryshme të artit, muzikës, pikturës, arteve marciale etj. Por sot është një ditë e veçantë, është festa e tyre, është festa e fundvitit.

Koncerti festiv ishte ndërtuar me plot këngë, valle, recitime, numra cirku etj, një program festiv, tërësisht i krijuar nga vetë fëmijët. Ai u hap me këngën "Merry Christmas". Pastaj në skenë erdhën recituesit e vegjël, me recitimet e tyre më të ndjeshme dhe me vjersha të përzgjedhura me kujdes, ndërsa kori i fëmijëve këndoi këngën e "Vitit të Ri". Nuk i kanë munguar këtij koncerti këngëtarët e mirënjohur Redon Makashi dhe Kozma Dushi, por edhe miqtë e tyre të vegjël, grupi i valltarëve të Qendrës Kombëtare Kulturore të Fëmijëve, një grup fëmijësh i Liceut Artistik, artistët e cirkut të Tiranës, të cilët me interpretimin e tyre të guximshëm i mahnitën të gjithë. Momente të bukura dhe prekëse krijuan sidomos fjalët e moderatores, kur artikuloi para të pranishmëve një falënderim të veçantë për ushtarakët që shërbejnë në misionet paqes jashtë atdheut. Në fund të këtij koncerti me vlera të larta artistike, fëmijëve të ushtarakëve dhe punonjësve civilë të FA iu shpërndanë dhuratat e Vitit të Ri, duke krijuar një atmosferë të gëzueshme dhe festive për të gjithë.

Ministria e Mbrojtjes, ndihma për Shtëpinë e të Moshuarve në Tiranë

"Ndihma e Forcave të Armatosura, është modeste, por flet për dashamirësinë dhe respektin tonë ndaj jush"

Në kuadër të festave të fundvitit, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, e shoqëruar nga një grup ushtarakësh, ka qenë sot në Shtëpinë e të Moshuarve në Tiranë, ku i dorëzoi të moshuarve që jetojnë këtu ndihma në veshmbathje dhe materiale të tjera, me një vlerë prej 300 mijë lekë (të reja). Ministrja Kodheli është takuar dhe ka biseduar nga afër me të moshuarit dhe personelin e këtij institucioni bamirësie.

Duke i përshëndetur ata, znj. Kodheli theksoi se, është në detyrimin tonë si Ministri e Mbrojtjes, por edhe i imi si ministre dhe si qytetare që t'ju gjendemi pranë dhe t'ju ndihmojmë brenda mundësive që kemi për t'ua bërë jetën tuaj këtu më të mirë dhe më të lumtur. Ndihma e Forcave të Armatosura, ka vijuar më tej ministrja Kodheli, është modeste, por flet për dashamirësinë dhe respektin tonë ndaj jush. Më pas, ministrja Kodheli i ka uruar të moshuarave të kësaj Shtëpie: Gëzuar festën e Krishtlindjes dhe të Vitit të Ri, duke i premtuar se do të shihemi sërish edhe përgjatë vitit që po vjen.

Forca Tokësore vjen në këtë analizë me arritje të shumta, të cilat u evidentuan edhe në analizat e zhvilluara në të gjitha strukturat e Forcës. Ai shkurtimisht bëri një ekspoze të disa nga arritjeve më të rëndësishme të vitit në Forcën Tokësore, si: përgatitjen e kontingjenteve në operacionet paqeruajtëse, arritjet në stërvitjet e shumta, ku u ndal në stërvitjen e b2k në Gjermani "COMBINED RESOLVE III", stërvitjeve në kushte fushimi në rajonin stërvitor të Bizës, stërvitjen në Qendrën e Simulimit të FA "Korabi-14" etj.

Gjeneralmajor Bazo: Stërvitja cilësore, ndërveprueshmëria dhe operacionaliteti rrisin kreditet e Forcave të Armatosura përkrah Aleancës

FT, në krye të detyrave për plotësimin me nder të misionit kushtetues

NËNKOLONEL EDIAND ELEZI

Forca Tokësore zhvilloi analizën vjetore për vitin 2014. Në analizë mori pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, drejtorë drejtorish në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, shtabi i forcës dhe komandantët e reparteve e nënreparteve. Analizën e hapi komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, i cili pasi falënderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazon, për pjesëmarrjen në këtë analizë, u shpreh se kjo analizë zhvillohet në një moment të rëndësishëm të ristrukturimit dhe të transformimit të Forcave të Armatosura dhe në këtë kuadër edhe të Forcës Tokësore dhe strukturave të saj, si dhe në atmosferën festive të festave te fundvitit. Më poshtë, gjeneralmajor Dushku theksoi se, Forca Tokësore vjen në këtë analizë me arritje të shumta, të cilat u evidentuan edhe në analizat e zhvilluara në të gjitha strukturat e Forcës. Ai shkurtimisht bëri një ekspoze të disa nga arritjeve më të rëndësishme të vitit në Forcën Tokësore, si: përgatitjen e kontingjenteve në operacionet paqeruajtëse, arritjet në stërvitjet e shumta, ku u ndal në stërvitjen e b2k në Gjermani "COMBINED RESOLVE III", stërvitjeve në kushte fushimi në rajonin stërvitor të Bizës, stërvitjen në Qendrën e Simulimit të FA "Korabi-14" etj. Gjeneralmajor Dushku përmendi kontributin e Forcës Tokësore për vitin 2014 në ndihmë të popullsisë, në aksionin për pastrimin e "Shqipërisë në një ditë" si dhe në realizimin e mjaft veprimtarive në kuadër të festimit të 70-vjetorit të Çlirimit të Atdheut. Në fund të fjalës së tij, komandanti i FT, gjeneralmajor Zyber Dushku, theksoi e vuri në dijeni shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, se nga Forca Tokësore janë marrë të gjitha masat e duhura për përgatitjen dhe përcjelljen e kontingjenteve të batalionit komando dhe batalionit special për misionin e radhës në Afganistan, si dhe për vënien në efiçencë të plotë të trupave, mjeteve dhe pajisjeve për emergjencat civile.

Në raportin e analizës që mbajti shefi i G3/7 kolonel Ilir Xhepaxhiu, theksoi se viti që po mbyllim ishte për Forcën Tokësore një vit angazhimi, përpjekjesh dhe aktivitetesh të rëndësishme për realizimin e objektivave të Direktivës së ministrit të Mbrojtjes, si dhe detyrave të vëna nga Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, një vit i cili shënoi një rritje cilësore për FT. Më tej ai bëri një përshkrim të përgjithshëm të të gjithë arritjeve dhe problematikave të hasura gjatë vitit 2014. Ndër drejtimet më të rëndësishme të punës gjatë vitit u trajtuan: hartimi i një planëzimi real e të zbatueshëm dhe realizimi me cilësi i masave të programuara; menaxhimi i personelit të FT-së; përmirësimi i elementëve të gatishmërisë luftarake; stërvitja dhe trajnimi i efektivave të FT-së me fokus të veçantë stërvitjen për realizimin e misionit kushtetues, për përballimin e emergjencave civile, si dhe në interes të pjesëmarrjes në misione jashtë vendit; pjesëmarrja në stërvitjet e përbashkëta me vendet aleate dhe partnere; certifikimi i nënreparteve për aftësinë luftarake te tyre; pjesëmarrja në operacionet në mbështetje të paqes jashtë vendit; pjesëmarrja dhe kontributi në Emergjencat Civile, si dhe përgjigja në kohën e duhur ndaj nevojave për mbështetje të strukturave të tjera shtetërore, sipas ligjit; mbështetja logjistike dhe administrimi i vlerave materiale, përqendrimi dhe kontabilizimi i vlerave materiale dhe monetare në reparte; rritja dhe forcimi i masave të ruajtjes dhe sigurisë në repartet e FT-së; standardizimi i proceduarave, miratimi dhe implementimi i STANAG-ve; rritja e nivelit të marrëdhënieve bilaterale me vendet aleate dhe partnere etj.

Në fjalën e tij shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, falënderoi efektivat e Forcës Tokësore për arritjet dhe në mënyrë të veçantë për kontributin e dhënë në pjesëmarrjet në misionet luftarake dhe paqeruajtëse, pjesëmarrjen në emergjencat civile, po ashtu edhe arritjet në drejtim të zhvillimit të stërvitjeve, sidomos stërvitjeve komplekse dhe ato të përbashkëta me aleatët. Më tej, gjeneralmajor Bazo e vuri theksin në përzgjedhjen e kontingjenteve në misione paqeruajtëse dhe të luftimit. Ai evidentoi se Forcat e Armatosura shqiptare kanë marrë vlerësime pozitive nga Aleanca, Departamenti i Mbrojtjes i SHBA, për performancën e shkëlqyer të treguar në misione. Në mënyrë të veçantë përmendi faktin e kontributit të Forcave Speciale dhe Komando Shqiptare në kryerjen e misioneve në Afganistan.

Në përmbyllje të fjalës së tij, shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA u shpreh se, viti 2015 është një vit me angazhime të shumta, ndaj dhe kërkohet një planëzim më konkret, më i detajuar si për aktivitetet brenda, ashtu dhe ato jashtë vendit, sidomos në kuadër të NATO-s. Ai i siguroi se Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, ashtu si deri më sot, do ta mbështes Forcën Tokësore për realizimin në kohë dhe me cilësi të detyrave, duke i krijuar më shumë hapësira e mundësi bashkëpunimi me strukturat e tjera të Forcave të Armatosura, për mbarëvajtjen normale të aktiviteteve dhe plotësim të objektivave të vitit 2015. Në fund, gjeneralmajor Jeronim Bazo uroi për Krishtlindjet dhe Vitin e Ri efektivin e Forcës Tokësore dhe në mënyrë të veçantë trupat e Batalionit Komando pjesëmarrës në misionin në Kabul të Afganistanit dhe familjet e tyre.

Nga ana e tij, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, e siguroi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së se, Forca Tokësore, efektivat e strukturave të saj vartëse, si gjithnjë do të vazhdojnë të jenë në krye të punëve, me disiplinë dhe përgjegjësi të lartë dhe për vitin 2015 do të realizojnë të gjitha detyrat që rrjedhin nga misioni i tyre kushtetues, si dhe çdo detyrë tjetër që do të dalin apo do të ngarkohen gjatë vitit që po vjen.

Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes bën bilancin e punës një vjeçare

KDS, motoja e punës për vitin 2015 do të jetë: Performancë-Cilësi-Reformë

NËNKOLONEL ALDA SULA

Arritjet e shënuara gjatë vitit 2014 në të gjitha strukturat e vartësisë së Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) i dhanë këtij institucioni të rëndësishëm të FA fizionominë e një institucioni të denjë për t`u përballur me sfidat e kohës. Kjo gjë u reflktua dhe në analizën vjetore të punës që Komanda e KDS -s zhvilloi këto ditë. Në këtë analizë mori pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, zv.komandanti i KDS, kolonel Ruzhdi Kuçi, komandantët e institucioneve arsimore dhe shefat e qëndrave në vartësi të KDS-s, shtabi i kësaj komande etj.

Shefi i Shtabit të KDS, kolonel Selim Troci, nëpërmjet një prezantimi, solli në analizë një panoramë përmbledhëse të të gjithë aktivitetit vjetor të KDS. Në qendër të vëmendjes së punës së KDS-s për vitin 2014 ka qenë realizimi i objektivave dhe veprimtarive kryesore të mbështetur në Direktivën e ministrit të Mbrojtjes, udhëzimet e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së për arsimimin e stërvitjen, për realizimin e objektivave të FA-së për vitin 2014, Matrica e Veprimtarive Kryesore për vitin 2014, Matrica e aktiviteteve të b/punimit dy palësh me vendet anëtare të NATO-s dhe ato partnere etj. Për 2014, KDS me institucionet e varësisë së saj, e kanë ndërtuar punën me prioritete. Ndër më kryesoret, vlejnë të përmënden: përgatitja dhe implementimi i Konceptit të Ri Arsimor Ushtarak; procesi i kalimit në strukturën e re organizative të strukturave të KDS-së; realizimi me sukses i Planit Vjetor të Arsimimit; impaktet mjaft pozitive të dhëna në personelin e KDS-së nga miratimi i Ligjit të Karrierës Ushtarake; realizimi i kurseve institucionale të oficerit, KLSM, KLO, KKSHP, KTHOSH; realizimi i kurseve institucionale të nënoficerit, KKK, KLNO, KANO, KBNO, KFNO; realizimi i kurseve profesionale në SHT (SIB, SIA, specialitetet); projektit pilot për përgatitjen e oficerëve të rinj në SHBA; rritja e performancës dhe aftësive mësimdhënëse të trupës pedagogjike; realizimi i studimeve strategjike, përpunimit doktrinar, si dhe zhvillimi i koncepteve operacionale; ridimensionimi i Shkollës së Trupës; rritja e rolit të Qendrës së Simulimit në zhvillimin e stërvitjeve të strukturave të FA dhe ato ndërinstitucinale; rritja e b/punimit me institucionet dhe organizmat jashtë strukturave të KDS-së etj, janë disa nga angazhimet dhe detyrat kryesore të realizuara me sukses gjatë këtij viti.

Realizimit me sukses të procesit mësimor i ka paraprirë më së miri puna e bërë nga institucionet e KDS-së dhe strukturat vartëse të tyre, duke marrë masa të mira për planëzimin në kohë të procesit mësimor, mbështetjen e tij, hartimit apo ripunimit materialeve mësimore, mbështetja me infrastrukturë e bazë materiale etj. Këtë vit në institucionet arsimore të KDS-së kanë kaluar në kurse të ndryshme më tepër se 26% e personelit të FA. Programet e kurseve janë orientuar dhe kanë synuar në dhënien e njohurive teorike dhe praktike. Gjithashtu, marrja pjesë në procesin e hartimit të Konceptit të Ri të Arsimimit Ushtarak Profesional (AUP) dhe në implementimin e tij ka qenë prioriteti nr.1 i punës pë arsimiin e stërvitjen. Në bashkëpunim me SHP të FA dhe Komandat e Forcave është punuar dhe për përgatitjen e dokumentit, Procedura Standarde Veprimi (PSV), i cili rregullon funksionimin, marrëdhëniet dhe përgjegjësitë e Qendrave/Seksioneve Stërvitore të Forcave dhe njësive të FA-së me Shkollën e Trupës të KDS.

Një tjetër aspekt në fushën e arsimim-stërvitjes gjatë 2014, kanë qënë dhe organizimi dhe drejtimi i qitjeve luftarake me armët e këmbësorisë, si dhe i testimeve në përgatitjen fizike të personelit të Komandës dhe strukturave të KDS-së, ku rezultatet jane evidentuar dhe hedhur ne sistem për tu ndjekur në ecuri, si një element vlerësues i performancës së ushtarakut.

Analiza vijoi me diskutime të titullarëve të institucioneve e qendrave të varësisë së KDS. Akademia e Forcave të Armatosura, ka punuar me ndjenjë përgjegjësie për realizimin në kohë e cilësi të detyrave të planëzuara dhe ato të ardhura nga strukturat eprore. Realizimit me sukses të procesit mësimor i ka paraprirë më së miri puna e bërë nga fakultetet, departamentet, duke marrë masa të mira për planizimin në kohë të procesit mësimor, mbështetjen e tij, hartimit apo ripunimit materialeve mësimore, mbështetja me infrastrukturë e bazë materiale etj. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2014, e cila përkon edhe me mbylljen e vitit akademik 2013-2014, AFA ka punuar me kapacitet të plotë duke realizuar me sukses të gjitha kurset institucionale të planizuara për këtë vit akademik. Një prioritet i punës arsimore e trajnuese të AFA ka qënë dhe angazhimi në përgatitjen dhe mbështetjen e programit pilot për trajnimin e oficerëve të rinj duke bashkëpunuar ngushtë me ekipin amerikan të ODC në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shkollën e Kandidatëve për Oficerë në Gardën e Nju Xhersit në SHBA, si dhe realizimit të KLSM 2014 (Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes). Për sa i përket realizimit të programit akademik, në AFA janë zhvilluar tre cikle kursesh në tre nivelet (2,2,2,2; 3,2,3,2 dhe 3,3,3,3) të gjuhës angleze duke kualifikuar në total 194 kursantë, ndërsa gjuhët e dyta janë zhvilluar me 66 vetë. Në kuadër të procesit te reformimit të strukturës së FA, bazuar në detyrat e vëna nga ministri i Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, si dhe të kërkesave të reja që dalin pas miratimit të Konceptit të ri për Arsimin Profesional Ushtarak, AFA ka si detyrë prioritare për periudhën aktuale, por edhe në vazhdim, rishikimin e përmirësimin tërësor të gjithë programeve të kurseve institucionale që zhvillohen në këtë institucion.

Akademia e Nënoficerëve, ka realizuar me sukses të gjitha kurset e planëzuara për vitin 2014, si Kursi Fillestar i N/oficerit, Kursi Bazë i N/oficerit, Kursi i Lartë i N/oficerit, Kursi i Avancuar i N/oficerit, Kursi i Instruktorit dhe Kursi i Administratës Civile. Personeli mësimdhënës ka punuar dhe vijon punën për rifreskimin e materialeve mësimore dhe për hartimin dhe miratimit e librave të programeve për kurset institucionale dhe funksionale në ANO, sipas Konceptit te Ri Arsimor Ushtarak në FA. Stërvitje trajnuese për Kurset Bazë dhe të Avancuar të Nënoficerit janë zhvilluar pranë Qendrës së Simulimit.

Shkolla e Trupës, ka pasur si objektiv rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e mëtejshëm të metodave të mësimdhënies në procesin mësimor. Rishikimi i programeve mësimore, përgatitja e personelit për mësimdhënie, organizimi i bashkëpunimit me komandat ku janë atashuar seksionet stërvitore, organizimi dhe zhvillimi i kurseve të planëzuara për vitin 2014 kanë qenë fokusi i punës së SHT. Përmirësimi i programeve ka synuar në zhvillimin e tyre për çdo fushë/lëndë, ku përfshihen përcaktimi i listës së aftësive, njohurive dhe cilësive që fitojnë kursantët për çdo program; përcaktimi i synimeve të çdo programi lëndor dhe objektivave për arritjet e kursantëve; si dhe metodologjia e mësimdhënies/nxënies dhe vlerësimit të kursantit; përfshirja e moduleve dhe temave të reja, i STANAGE-ve të ratifikuara dhe mësimeve të nxjerra; formatimin e standardizuar të gjithë programeve të kurseve institucionalë që zhvillohen në SHT. Gjatë këtij viti në SHT është trajnuar një personel i konsiderueshëm i Forcave të Armatosura.

Në Qendrën e Simulimit janë realizuar rreth 11 stërvitje simuluese me komandat dhe shtabet e njësive dhe reparteve të FA nga niveli kompani e batalion deri në nivel QBO dhe brigade. Të gjitha stërvitjet janë zhvilluar sipas një procesi planëzimi standard bazuar në Direktivën e Stërvitjes së FA-s, DS7-1, por më kryesisht në atë të NATO-s Bi-SC Exercise 75-3 (NATO), duke ndjekur dhe zbatuar me korrektësi të gjitha fazat e planëzimit dhe zhvillimit të saj. Gjatë këtij viti, në QS janë zhvilluar të gjitha stërvitjet e planifikuara me kurset institucionale të AFA-së e ANO-së. Për stërvitjen Ndërinstitucionale për Emergjencat Civile "MORAVA-14", është ndërtuar Skenari i Stërvitjes, është përgatitur Vlerësimi Operacional i Mjedisit si dhe specifikimet dhe dokumentacioni që kërkon Plani të Zhvillimit të Stërvitjes.

Qendra e Doktrinës dhe Kërkimit ka realizuar me përparësi dy veprimtari me pjesëmarrje gjithperfshirese, sikurse është promovimi i publikimeve doktrinare dhe konferenca shkencore për doktrinën. Në fushën e Studimeve Strategjike përparësi ka qenë planifikimi i drejtë, i diktuar nga zhvillimet dhe situata gjeostrategjike dhe mbështetja e lidershipit me studime strategjike dhe rekomandime. Në fushën e zhvillimit të Doktrinës u zhvillua Konferenca Shkencore "Zhvillimi i Doktrinës Ushtarake në një mjedis të ndryshueshëm të sigurisë e të mbrojtjes". Gjithashtu është ripunuar projekt-drafti i "Rregullores së Gatishmërisë Luftarake të FA" dhe rregullores "Sistemi i Vlerësimit të Gatishmërisë Luftarake (SVGL)", si dhe janë hartuar manualet "Planëzimi Operacional" (MP-5-0), "Planëzimi Taktik" (FT-5-0) dhe "Taktikat, Teknikat dhe Procedurat (TTP) e togës/kompanisë së këmbësorisë në operacionet kryesore". Në Procesin e Standardizimit është përgatitur "Lista e Kërkesave Prioritare të FA" për ratifikimin e STANAG/AP për vitin 2014 dhe miratimin nga Bordi i Standardizimit. Po punohet për përgatitjen e raporteve analitikë për një sërë STANAG-ësh, duke kompletuar numrin e përgjithshëm të STANAG-ve të FA, të ratifikuar në 217. Këtë vit janë ratifikuar 15 STANAG-ë dhe janë në proces për mbledhjen e radhës 12 STANAG-ë të FA-ve etj.

Në analizë u trajtuan dhe çështjet dhe problematikat që kanë të bëjnë me procesin e planëzimit, drejtimit, mbështetjes dhe kontrollit, proces që përfshin personelin, çështjet e sigurisë dhe operacionet, problemet e mbështetjes logjistike, të planifikimit, financës dhe bashkëpunimit civilo-ushtarak dhe informimit.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo duke marrë fjalën në këtë analizë, pasi përgëzoi për punën e bërë dhe vlerësoi arritjet e institucioneve të KD-së, theksoi se, viti 2015 do të tregojë rrugën se si do të ecet në karrierën e ushtarakut, në aspektin e shtimit të përgjegjësive. Rregulli e disiplina duhet të na karakterizojë edhe gjatë vitit në vijim. Në përfundim të analizës, zv/komandanti i KDS, kolonel Ruzhdi Kuçi, duke përmbledhur në vija të përgjithshme momentet kryesore të punës së Komandës së KDS-së, sfidat dhe angazhimet, falënderoi të gjithë stafin, personelin ushtarak e civil të KDS, AFA, ANO, SHT, QDK, QS, Shtabin e KDS për punën e bërë, arritjet, realizimin e synimeve dhe objektivave të përcaktuara, sjelljen e risive e ambicieve të reja, në sinkron me direktivat e shtruara, për përkushtimin maksimal të treguar në realizimin e sfidave të vitit, duke e kthyer institucionin e KDS, një strukturë mjaft të konsoliduar në fushën e arsimimit ushtarak. Për vitin 2015 motoja e punës në KDS do të jetë: Performancë-Cilësi-Reformë.

Gjeneralmajor Bazo: QBO duhet t'i kushtojë më shumë rëndësi stërvitjes dhe trajnimit të personelit të saj

QBO një strukturë e rëndësishme e Forcave të Armatosura

Qendra e Bashkuar Operacionale (QBO) zhvilloi analizën e punës për vitin 2014. Mori pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo

NËNKOLONEL ARJAN HORA
Oficer Shtabi për Operacionet

Më datën 22.10.2014, në ambientet e Qendrës së Bashkuar Operacionale (QBO) u zhvillua analiza vjetore e punës së kësaj strukture të rëndësishme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm. Në analizë mori pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Analiza e vuri theksin në punën e bërë për realizimin e detyrave në interes të përmbushjes së misionit të QBO-së, forcimin e masave të sigurisë, monitorimin e trupave në misione paqeruajtëse, ndjekja e procedurave për kalimin transit të trupave dhe mjeteve në territorin e RSH, menaxhimin e rasteve të emergjencave civile dhe operacioneve të kërkim-shpëtimit si dhe pjesëmarrja dhe ndjekja e stërvitjeve të ndryshme të zhvilluara nga strukturat e FA-së brenda dhe jashtë vendit gjatë vitit 2014. Pjesë e veprimtarisë së QBO-së kanë qenë dhe pjesëmarrja në stërvitje të ndryshme të organizuara nga QBO dhe në kuadër të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së për menaxhimin e emergjencave civile dhe zhvillimi i trajnimeve me personelin e QBO-së për aftësimin në përmbushjen e detyrës funksionale.

Qendra e Bashkuar Operacionale për vitin 2014 një vëmendje të veçantë i ka kushtuar monitorimit dhe mbështetjes së kontingjenteve tona paqeruajtëse duke mbajtur një komunikim të vazhdueshëm me përfaqësuesit tanë në shtabet e NATO-s dhe me kontingjentet si "Eagle 7" dhe "Eagle8" në Kandahar, përfaqësuesit në shtabet e ISAF-it, OMLT-4, OMLT-5 në Kabul, Afganistan, kontingjentet 5 dhe 6 në Kosovë. Gjithashtu, gjatë vitit 2014 i është kushtuar vëmendje edhe menaxhimit të rasteve të Emergjencave Civile dhe operacioneve të kërkim-shpëtimit. QBO ka koordinuar punën midis strukturave të FA-së dhe pushtetit vendor për menaxhimin e të gjithë rasteve të emergjencave civile ku për tu përmendur janë:

- Menaxhimi dhe ndërhyrja e shpejtë për shpëtimin e jetës së ushtarakëve në aksidentin e ndodhur në Qafë-Priskë, ku si rezultat i rrëzimit të makinës u plagosën 3 ushtarak.

- Menaxhimi i operacionit për transport ndihmash në mbështetje të komunitetit në zonën e Lumit të Gashit, Tropojë me pjesëmarrjen e helikopterit tip AS532AL (631), të Bazës Ajrore Farkë

- Koordinimi dhe monitorimi i operacionit për një Shqipëri të pastër, me moton "Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë atë të pastër", në të gjithë prefekturat e vendit, ku morën pjesë 1038 forca dhe 80 mjete nga strukturat e FA (shkurt- mars 2014).

- Koordinimi dhe monitorimi i operacionit në kuadër të projektit të pastrimit të zonave turistike nga ndotja, me moton "Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë atë të pastër", për rehabilitimin e mjedisit në plazhet e Velipojës, Shëngjinit, Patokut, Porto-Romanos, Currila, Ura e Dajlanit, Kavalishenca, Shkëmbi i Kavajës, Golemit, Spillesë, Divjakë, me pjesëmarrjen e 1412 forca, 94 mjete të FA (maj 2014).

- Koordinimi dhe monitorimi i punës për përmirësimin e kushteve të sigurisë në plazhe dhe në zonat çlodhëse në bregdet, ku QBO ka luajtur një rol të rëndësishëm në evidentimin dhe pasqyrimin e aktivitetit ditor të strukturave të FA-së të angazhuara në plazhet: Velipojë, Shëngjin, Tale, Gjiri i Lalëzit, Durrës, Golem, Vlorë, Dhërmi, Himarë dhe Borsh.

- Menaxhimi dhe koordinimi i strukturave të FA-së për përballimin e pasojave të përmbytjeve të shkaktuara nga reshjet e dendura në qarqet Tiranë dhe Lezhë më datën 18-20 nëntor 2014, ku u angazhuan 111 forca, 16 mjete transporti, 1 mjet zjarrfikës, 1 mjet fadromë, si dhe vendosën 10.000 thasë me rërë.

Pjesë e pandarë e punës ka qenë edhe menaxhimi i operacioneve të kërkim-shpëtimit. Kështu mund të permendet menaxhimi i operacionit në rajonin Kepi i Palit-Grykëderdhja e lumit Shkumbin-Kepi i Palit, në ndihmë të peshkarexhës "Katerini" me pjesëmarrjen e Flotiljes Detare Pashaliman me anijen "P-04" dhe anijen "P-133", më datë 20.03.2014. Në përfundim të operacionit u bë i mundur shpëtimi i ekuipazhit të anijes; operacioni për gjetjen e personit të vet-hedhur nga tragheti "BRIDGE" i linjës Bari-Durrës me pjesëmarrjen e anijes së gatshme P-04 "Semani" dhe anijes P-133 "Lisus" të Forcës Detare, në bashkëveprim me gomonen 118 të Guardia di Financës, më datë 19.04.2014; operacioni për dhënie ndihme një skafi me dy persona në bord, me flamur anglez, i cili kërkonte ndihmë, pasi i ishin fikur motorët, ku u angazhua Flotilja Detare Pashaliman, me anijen P-131, më datë 22.05.2014, pas marrjes së njoftimit nga Kapitaneria e Portit Vlorë; operacioni për dhënie ndihme dhe rimorkim të skafit "REMA" me flamur italian me 5 (pesë) persona në bord në grykëderdhje të lumit Seman, me pjesëmarrjen e anijes P-02 e dislokuar në Sazan, më datë 11.08.2014; operacioni në ndihmë të 5 barinjve dhe një sasie bagëtish të bllokuar nga dëbora në majën e Papingut, mali i Nemërçkës, më datë 26.10.2014 ku u angazhua një helikopteri tip AS532AL (633) etj.

Gjate këtij viti nga QBO janë ndjekur, monitoruar, evidentuar dhe pasqyruar edhe stërvitjet e ndryshme të kryera nga strukturat e FA-së brenda dhe jashtë vendit, si dhe në bashkëpunim me partnerët e NATO-s ku më kryesoret kanë qenë: stërvitja "Albania Lion 14", stërvitja "Joint Reaction 15", stërvitja "Joni-2014", "QUAKE-2014" "Gorica-2014", "Korabi", "Taraboshi–14" etj.

Një punë e mirë është bërë për përgatitjen e procedurave standarde të veprimit ku mund të përmendim: Procedurat Operacionale Standarde (PSO) për Emergjencat Civile, për Kërkim -Shpëtimin (SAR), për ngjarjet e jashtëzakonshme në FA, për Vendin Pritës (HNS) etj.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, pasi falënderoi personelin e QBO-së për punën e bërë gjatë vitit 2014, shtroi disa detyra për të ardhmen. Qendra e Bashkuar Operacionale, theksoi gjeneralmajor Bazo, është kompletuar me personel të përzgjedhur dhe me një eksperiencë të pasur operacionale nga misionet brenda dhe jashtë vendit. Duke vlerësuar punën tuaj në këto dy muaj, sidomos për zhvendosjen dhe vënien në gatishmëri të QBO-së në ambientet e reja, kërkoj që kjo punë të vazhdojë edhe më tej, për t'i dhënë QBO-së rolin dhe vendin që i takon në strukturën e Forcave të Armatosura. Në operacionet e Emergjencave Civile, nënvizoi më tej ai, marrin pjesë shumë uniforma, që nga ato të policisë, shëndetësisë, zjarrfikësve etj, por eksperienca ka treguar se popullsia civile ka më shume besim tek uniforma ushtarake, tek aftësitë profesionale të tyre, tek përkushtimi dhe ndershmëria në kryerjen e detyrës. Prandaj dhe duhet të punojmë më shumë që ta meritojmë e ta justifikojmë këtë besim.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm u ndal në punën me procedura standarde. Ai theksoi se Qendra e Bashkuar Operacionale, nuk është një strukturë e re, ajo ka vite që funksionon, por ka ardhur koha që të heqim dorë nga "celulari" dhe "lidhjet shkurt" gjatë përballimit të emergjencave civile dhe ngjarjeve të jashtëzakonshme. Qendra e Bashkuar Operacionale duhet të operojë me procedura standarde veprimi për çdo situatë të krijuar, punë e cila ka filluar të bëhet në QBO dhe për këtë ju përgëzoj dhe ju mbështes. Në vazhdim, shefi i Shtabit të Përgjithshëm kërkoi që me punën e të gjithë personelit të QBO-së të synohet për përmirësimin e imazhit dhe të opinionit që ekziston për këtë strukturë të rëndësishme të FA-së. "Ka një opinion, jo shumë të drejtë për punën e QBO-së, - theksoi gjeneralmajor Bazo, - Ky opinion e percepton punën e QBO-së si një punë vetëm për grumbullimin informacionit për aktivitetin e Forcave të Armatosura, informimin e eprorit dhe marrjen e masave deri në marrjen e situatës nga Shtabi i Përgjithshëm i FA-së. Ky opinion duhet të ndryshojë. QBO mbështet procesin e komandim-kontrollit në nivelin operativo-strategjik të Forcave të Armatosura, si dhe ushtron drejtpërdrejtë atë në planëzimin, koordinimin dhe drejtimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë, në kushte emergjence kohe dhe forcash të kufizuara. Që të realizojë misionin e saj, QBO duhet t'i kushtojë një rëndësi të madhe stërvitjes dhe trajnimit të personelit të saj. Në këtë kontekst ju rekomandoj të planëzoni dhe zhvilloni stërvitje në nivel force të armatosur për emergjencat civile dhe operacionet e kërkim-shpëtimit".

Për vitin 2015 objektivat dhe detyrat janë mjaft ambicioze. Puna do përqendrohet në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Direktiva e ministrit të Mbrojtjes për vitin 2015 ku më kryesoret do të jene: Përcaktimi i qartë i linjës së komandim-kontrollit (procedurat e operimit), nëpërmjet përgatitjes SOP-ve përkatëse, përgatitja e Planit Kombëtar të Kërkim Shpëtimit, përgatitja e Manualit Kombëtar të Kërkim Shpëtimit, rishikimi i manualit "Forcat e Armatosura në Emergjencat Civile" dhe Rregullores së Brendshme të QBO/QKKSH.

Mbrojtja Civile në Bashkimin Evropian

Takimi i Dytë i Komitetit Drejtues të IPA CP II

ARBEN MOLLAJ,
specialist i Emergjencave Civile

Bazuar në Programin e Bashkëpunimit të Mbrojtjes Civile në BE-IPA CP II, më 10-12 dhjetor 2014 në Budva të Malit të Zi u zhvillua Takimi i Dytë i Komitetit Drejtues të IPA CP II dhe mësimet e nxjerra IPA MNE QUAKE 2014. Forcat tona të Armatosura, si pjesë përbërëse e ekipit shqiptar, bazuar në bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme te Emergjencave Civile në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ishin pjesë e këtij takimi. Ekipi shqiptar u përfaqësua me tre vete, nga ku dy ishin nga Forcat e Armatosura: Arben Mollaj, specialist i emergjencave civile dhe kapiten Gentian Halili, zv/komandant i kompanisë se kërkim-shpëtimit..

Përfaqësuesit në takim, kanë qenë të angazhuar gjatë ushtrimeve në tavolinë, zhvilluar në Durrës, 1st Team Management Course (TMC) në periudhën 9-13 qershor 2014 dhe stërvitjes fushore me skenar tërmetet, të koduar IPA MNE QUAKE 2014.

Objektivi i përgjithshëm ishte për të reduktuar vullnetarizmin e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë në fatkeqësitë natyrore dhe i bërë nga niveli kombëtar dhe atë rajonal, nëpërmjet: rritjes së aftësisë për të bashkëpunuar në mënyrë efektive me Mekanizmin (BE) për Mbrojtjen Civile të Bashkimit dhe të institucioneve përkatëse; rritjes së aftësisë për të zhvilluar më tej sistemet e efektshme të reagimit kombëtar të mbrojtjes civile dhe bashkëpunimit në nivel rajonal.

Qëllimi i këtij takimi ishte vijimi i përpjekjeve për të kombinuar organizimin e ngjarjeve të ngjashme brenda programit të bashkëpunimit për mbrojtjen civile në kuadër të IPA-s (instrumenti i paraderimit në BE) në Evropën Juglindore në fushën e mbrojtjes civile.

Takimi u përshëndet nga drejtuesi i projektit z. Branko Dervovel, n/drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes Civile të Sllovenisë dhe drejtues i Programit II të bashkëpunimit për mbrojtjen civile të vendeve të IPA-s dhe nga z. Hans Das, kreu i Politikave të Mbrojtjes Civil, pranë Komisionit Evropian dhe Departamentit të Mbrojtjes Civile për ndihmën humanitare i (ECHO). Gjatë aktivitetit kishte përfaqësues nga Këshilli i Evropës; Ddejtues të Projektit IPA CP II, Programi i dytë, ekspertë për Mbrojtjen Civile nga vendet e BE-së, përfaqësues nga Mali i Zi, Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Serbia, Sllovenia, Bosnje-Hercegovina, Kroacia dhe Turqia.

Moderatorja e takimit falënderoi shtetet pjesëmarrëse në këtë program, si një vazhdim i Mbrojtjes Civile IPA të Bashkëpunimit Programit I që përfundoi në maj 2013: Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Kosova, Turqia. Gjithashtu u vlerësuan partneret zbatues të Projektit, Sllovenia, Kroacia, Italia, Gjermania, Suedia dhe Sllovenia.

Në takimin e Grupit Drejtues për Programin e II të Bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes Civile të IPA-s , u trajtuan:

Komponenti 1 – Rritja e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe shkëmbimit të ekspertëve.

Gjatë fazës fillestare partnerët ranë dakord mbi një përzgjedhje të trajnimeve, që do të zhvillohen gjatë 2015 në Serbi, Bosnjë-Hercegovinë dhe Turqi. Programi i trajnimit përfshin të paktën 5 kurse në vijim të kurseve të trajnimit Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së me përshtatjen ndaj nevojave rajonale.

Shkëmbimi i eksperiencave do të zhvillohen gjatë 2015 në Gjermani dhe Kroaci, me përfshirjen edhe të shkëmbimit të eksperiencës nga ekspertë të vendeve të rajonit.

Komponenti 2 – Rritja e kapaciteteve nëpërmjet ushtrimeve. U bë një rezyme e aktiviteteve për 2014, si ajo me skenar tërmetet ne Mal të Zi, IPA MNE QUAKE 2014 dhe stërvitjet për 2015, ku kryesorja do të jetë stërvitja në Maqedoni (për këtë rëndësi do t'i kushtohet konferencave planëzuese deri në përfundimin e stërvitjes).

Komponenti 3 – Rritja e kapaciteteve nëpërmjet TTX, HNS, ëorkshopeve – TTX,

HNS dhe ëorkshopeve për asistencë teknike. Gjatë vitit 2015 do të ketë në Serbi, Kosovë, Shqipëri, Turqi dhe Maqedoni. Një ushtrim në tryezë në secilin vend përfitues me fokus mbështetjen e vendit mikpritës (HNS). Ushtrimet do të përfshijnë përfaqësues nga institucionet kombëtare përkatëse për ofrimin e HNS. Dy seminare (Ëorkshop) të lidhur me politika dhe tema të rëndësishme për parandalimin e fatkeqësive, gatishmërisë dhe reagimit në nivel rajonal BE. M

Mbështetje Teknike - Ofrimi i mbështetjes teknike, nëse kërkohet, për zhvillimin e procedurave standarde operative, sipas legjislacionit te vetë vendeve dhe mekanizmit të mbrojtjes civile në BE.

Mësimet e nxjerra për IPA MNE QUAKE 2014 (me skenar tërmetet)

Gjatë brifingjeve dhe diskutimeve që u zhvilluan nga pjesëmarrësit dhe drejtuesit e projektit u evidentuan përvojat pozitive dhe mësimet e nxjerra. Më konkretisht ato janë si më poshtë:

- Mundësi e mirë mësimi për të gjithë aktorët e përfshirë në kuadër të mbrojtjes civile;
- Përmirësimi i ndërhyrjeve të përbashkëta për aktivizimin e mekanizmit të mbrojtjes civile dhe të bashkëpunimit operacional për vendet e BE-së;
- Forcimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimi rajonal. Bashkëpunimi dhe koordinimi në situata emergjente është kryesore;
- Dukshmëri e zgjeruar e aktiviteteve të mbrojtjes civile në BE dhe njohja e rritja e kontributit BE-së në rajon;
- Vlerësimi i kontributeve të vendeve të rajonit për situatën e përmbytjes në Bosnjë -Hercegovinë, Serbi dhe Itali;
- Planifikim i duhur me përfshirjen aktive të të gjitha vendeve partnere dhe bashkëpunim të ngushtë për organizimin e mbrojtjes civile është çelësi për ushtrime të suksesshëm;
- Përfshirja e pjesëmarrësve me rolet dhe përgjegjësitë e tyre për shkak të aktiviteteve të mëparshme rajonale në kuadër të programeve të IPA-s dhe DPPI SEE;
- Nevoja për vijimin e projekteve BE-së (multinacionale ose bilaterale) që mundësojnë blerjen e pajisjeve;
- Aktivizimi nga vendet pjesëmarrëse, personel nga mbrojtja civile, vullnetar, drejtues dhe ekspert të fushave për mbrojtjen civile etj.

Programi aktiviteteve për Mbrojtjen Civile IPA-s për 2015

Aktivitetet kryesore dhe mjetet për vijimin e programit janë të destinuara për të nxitur ndërtimin e kapaciteteve në nivele administrative dhe operacionale. Kjo do të arrihet nëpërmjet trajnimeve, ushtrimeve fushore, ushtrime në tryezë, shkëmbimin e ekspertëve, diskutim i bazuar në bashkëpunimin e vendeve, mbështetje teknike dhe rrjetet mbështetëse të palëve të ndryshme në Ballkanin Perëndimor dhe Turqisë me shtetet anëtare të BE.

Diskutimet vijuan me përfshirjen e të gjithë aktorëve ne rajon. U theksua domosdoshmëria e trajnimit të eksperteve, trajnimi të drejtuesve, trajnimit të ekipeve dhe ushtrimeve ne terren, ku kryesore do të jetë stërvitja në Maqedoni në periudhën 15-19 qershor. Vijimi i ushtrimeve dhe trajnimeve për koordinimin dhe mbështetja e vendit pritës (HNS). Të gjitha vendet partnere do të organizohen për të mbështetur forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me BE-në. Partnerët IPA do të marrin pjesë në takime të përbashkëta mbi bazën e kapaciteteve të deklaruara, si dhe do të mundësimi për tu aktivizuar në të ardhmen bazuar në kërkesat e vendeve të rajonit në fushën e mbrojtjes civile për projektet e IPA-s .

Batalioni II Këmbësorisë i Forcës Tokësore kreu një marshim në relief të vështirë dhe në mot të keq

Ditë plot ngarkesë dhe stërvitje në FT

KOLONEL HYSNI GJERGJI,
NËNKOLONEL EDIAND ELEZI

Në ballë ishin edhe femrat e këtij batalioni, të cilat marshuan njëlloj me shokët e tyre, duke mbajtur të njëjtën ngarkesë mbi supe dhe duke treguar po të njëjtën vendosmëri për t'i shkuar deri në fund detyrës së marrë

Bilanc i pasur arritjesh

Në këto ditë të fundvitit tek efektivat e njësive dhe reparteve të Forcës Tokësore ndjehet një frymë më e lartë mobilizimi dhe përkushtimi për të përmbushur të gjitha detyrat dhe objektivat e përcaktuara. Bilanci është i pasur, arritjet janë të dukshme, shembujt pozitiv të panumërt. Në këtë kontekst, mund të permendim stërvitjet sipas standardeve të NATO-s, pjesëmarrjen në stërvitjet e përbashkëta komplekse me strukturat homologe të NATO-s dhe vendeve partnere të zhvilluara jashtë Shqipërisë, pjesëmarrjen në operacionet në ndihmë të popullsisë nga përmbytjet dhe moti i keq, për mbrojtjen e ambientit etj. Në këtë gamë të gjërë veprimtarish dhe arritjesh veçojmë stëvitjen "Taraboshi-14" që u zhvillua në Qendrën e Simulimit të Forcave të Armatosura nga data 1 deri më 16 dhjetor 2014 me pjesëmarrjen e Batalionit të Parë të Këmbësorisë të Vaut të Dejës, Batalionit të Tretë të Këmbësorisë të Poshnjës, si dhe të Batalionit Komando, e cila u bazua duke aplikuar direktivën e stërvitjes së NATO-s, BI-SC 75-3 dhe Manualin e Ushtrisë Amerikane TC-7 101 "Planëzimi i stërvitjes në Shtab", ku i gjithë dokumentacioni dhe procedurat u zbatuan përgjatë dinamikës së stërvitjes. Më 16 dhjetor u nisën për në Kabul, Afganistan, 30 trupa të kontingjentit të ri të Batalionit Komando të Forcës Tokësore (në fakt në renditje ai është i 21-ti), i cili do të veprojë në kuadër të misionit "Resolute Support".

Gjithashtu mund të përmendim dhe disa nga stërvitjet e spikatura të reparteve të Forcës Tokësore si: stërvitja komplekse e zhvilluar në rajonin Krrabë - Baldushk - Pezë - Qafë Priskë, me kursin e 9-të bazë të Forcave Speciale; stërvitja e përbashkët "Joni-14" në Pashaliman, me Qëndrën e Zhytjes dhe Flotiljen Detare të Vlorës, zhvilluar nga Batalioni Special; stërvitja "Combined Resolve III" e zhvilluar në Qendrën e Bashkuar Ndërkombëtare të Gatishmërisë (JMRC) në Hohenfels, Gjermani nga Kompania e Parë e Batalionit të Dytë të Këmbësorisë (k1b2k), si dhe shumë stërvitje të tjera. Të gjitha këto kanë rritur më tej aftësitë profesionale të trupave të Forcës Tokësore, kanë përfeksionuar më shumë kompaktësimin, bashkëveprimin dhe koordinimin e veprimeve luftarake të reparteve dhe nënreparteve, duke arritur njëkohësisht edhe objektivat dhe standardet e kërkuara nga NATO.

Një marshim që flet shumë

Në kuadrin e këtij mobilizimi dhe angazhimi e në zbatim të planit të stërvitjeve të planifikuara edhe Batalioni i Dytë i Këmbësorisë, i dislokuar në rajonin e Zall-Herrit zhvilloi një marshim me itinerarin Zall-Herr - Ura e Pinarit me një gjatësi prej rreth 15 kilometra. Qëllimi i këtij marshimi ishte kompaktësimi i trupave të batalionit gjatë marshimit, si dhe rritja e kondicionit fizik të tyre. Marshimi u realizua në një relief të vështirë, malor dhe kodrinor, me shumë pengesa e vështirësi, pengesa ujore të rrëmbyeshme dhe në një mot të ftohtë dimri. Terreni malor i thepisur kushtëzoi përdorimin shpesh herë të mjeteve alpine. Ishin pothuajse i gjithë efektivi i batalionit, oficerë, nënoficerë dhe ushtarë profesionistë, të ngarkuar me të gjitha pajisjet luftarake personale, të cilët si një trup i vetëm marshuan, duke kryer edhe mjaft veprime sipas situatave të ndryshme luftarake që jepeshin gjatë marshimit.

Urdhëri për lëvizjen efektivit të batalionitë u dha në orën 09.00 dhe marshimi nisi konform të gjitha rregullave. Në krye paraprinte pararoja dhe më pas vinin trupat kryesore. Pavarësisht motit të keq dhe me shi i gjithë efektivi i b2k zhvilloi marshimin e programuar me perkushtim të lartë dhe shpirt gare. Gjatë gjithë itinerarit të marshimit nuk pati asnjë incident, asnjë plogështi apo shënjë lodhjeje nga efektivi. Rreth orës 12.30 batalioni arriti në Urën e Pinarit, e cila ndodhet në dalje të fshtit Pinar, ku ishte edhe kufiri i fundit i detyrës së këtij marshimi. Trupat e përshkuan këtë distancë 23 minuta më shpejt nga çishte parashikuar. Nëpërmjet këtij marshimi, ky repart demonstroi edhe njëherë tjetër vendosmërinë e tij drejt rrugës për arritjen e objektivave dhe standardizimin e stërvitjeve duke ju afruar gjithnjë e më shumë standardeve të ushtrive aleate të NATO-s. Ky marshim u drejtua me kompetencë dhe profesionalizëm nga komandanti i batalionit, nënkolonel Edmond Sardi, i cili ndoqi me shumë përgjegjësi dhe hap pas hapi të gjitha etapat e tij. Efektivi pjesëmarrës në këtë stërvitje tregoi që gëzon një përgatitje fizike dhe taktike të lartë, të domosdoshme për stërvitje të këtij karakteri. Përgatitja fizike dhe përballimi i kushteve të vështira të terrenit dhe motit është kusht kryesor për suksesin e kësaj stërvitje. Dhe ata e manifestuan këtë përgatitje më së miri. Emrat e ushtararakëve që u dalluan në këtë stëvitje ishin të shumtë, por nuk mund të lëmë pa përmendur sidomos Ervinin, Blerimin, Sandrin, Ilirin etj, të cilët me shembullin e tyre udhëhoqën efektivin. Por këtë radhë nuk kanë qënë vetëm meshkujt triumfatorët, ata që udhëhoqën dhe i dhanë shpirt këtij marshimi. Përkrah tyre dhe në ballë ishin edhe femrat e këtij batalioni, të cilat marshuan njëlloj me shokët e tyre, duke mbajtur të njëjtën ngarkesë mbi supe dhe duke treguar po të njëjtën vendosmëri për t'i shkuar deri në fund detyrës së marrë. Tek secila prej tyre shikohej një vendosmëri e tillë sa që lodhja kishte frikë të shfaqej dhe pikat e shiut shërbenin vetëm për të freskuar fytyat e tyre djesitura.Togere Aferdita Zoga dhe nëntogere Albana Çejku treguan se në disa raste ishin më të afta se djemtë, duke marshuar përkrah tyre. Por edhe Eva, Klodjana, Ridvana etj nuk mbetën më prapa, edhe ato treguan se janë të përkushtuara në zbatimin e detyrave. Ky marshim dëshmoi dukshëm gjendjen e mirë fizike të të gjithë personelit femër të këtij batalioni, si dhe aftësitë e tyre për përballimin e sfidave edhe më të vështira.

Në përfundim të marshimit komandanti i batalionit, nënkolonel Edmond Sardi, bëri analizën e realizimit të këaj detyre, duke falënderuar gjithë efektivat e nënreparteve për disiplinën e treguar gjatë marshimit. Ai ka veçuar të gjitha femrat në falenderimin e tij duke shprehur mirënjohje dhe besim se ato mund të bëjnë shumë më shumë se kaq dhe u ka dhënë atyre kurajo se duke vepruar në këtë mënyrë e bëjnë realitet të prekshëm barazinë gjinore në të gjitha aspektet. Të gjithë këto tregues flasin qartë edhe një herë jo vetëm për përkushtimin e trupave të b2k në realizimin e detyrave luftarake në kushtet me terren dhe mot te rënduar, por edhe shkallën e lartë të aftësive të tyre profesionale që i përgjigjet edhe standardeve të NATO-s. Ky batalion mbetet një nga repartet elitë të Forcës Tokësore.

Luiza Gega, atlete e mirënjohur dhe përfaqësuese e denjë e FA

Prej 10 vitesh është kampione e Shqipërisë dhe Ballkanit në garat 800, 1500 dhe 3000 metra me pengesa

ETLEVA SMAÇI

Luiza është shembulli se me punë mund të arrihet gjithçka, është model i vënies së arritjeve në shërbim të atdheut, sepse medaljet e Luizës nuk janë vetëm krenaria e saj, janë krenaria e ushtrisë sonë, janë krenaria e Policisë Ushtarake ku punon...

Dhjetori ka hyrë me ritëm festiv. Ngado që të kthesh sytë të duket sikur festat të përshëndesin e të ftojnë të përfshihesh në atmosferën e tyre. Mëngjeset edhe pse të ftohtë duket se kanë ngrohtësinë e pragfestave të fundvitit. Këtij gëzimi i shtohet kureshtja për takimet e ditës, njohjet e reja, personazhet e radhës që pret të takosh. Destinacioni ynë i fundvitit është Policia Ushtarake. Kemi lënë takim me një pjesëtare të saj, por që është ndryshe nga vajzat e tjera të kësaj njësie ushtarake të Forcave tona të Armatosura, pasi është edhe një atlete e mirënjohur, një kampione me shumë medalje. Sot do të takohemi me Luiza Gegën. Prej 10 vitesh ajo është kampione e Shqipërisë dhe Ballkanit në garat 800, 1500 dhe 3000 me pengesa. Tre vitet e fundit ka shënuar disa rekorde, duke u radhitur krah për krah emrave të mëdhenj të atletikës shqiptare, si Pavlina Evro. Gjatë vitit 2014, krahas karrierës së saj si ushtare profesioniste në Policinë Ushtarake, Luiza ka vazhduar të jetë sportistja elitare e rekordeve të mëdha. Kujtojmë garën e saj në Tbilis, Gjeorgji, më 21 qershor apo garën në 3000 m me pengesa në Pekin më 21 maj. Po ashtu nuk ka munguar të jetë edhe sportistja e kauzave të mëdha humanitare. Ndaj kjo ditë me Luizën është vërtetë një ditë e veçantë për mua, një ditë që nuk të takon shpesh ta përjetosh me kaq emocion.

Luiza Gega është një vajzë imcake dhe për të gjithë ata që e takojnë për herë të parë, natyrshëm mund të lind pyetja: "ku fshihet gjithë ajo forcë, gjithë ajo energji, në këtë fizik të brishtë?". Dikur në fëmijëri një vajzë e shkathët, ose e ngjashme me një djalë çapken, siç i pëlqen asaj ta quaj veten, pjesën më të madhe të kohës e kalonte në shoqërinë e djemve të lagjes, madje edhe loja e saj e preferuar ishte futbolli. Vraponte dhe hahej me ta "dhemb për dhemb" për t'u rrëmbyer topin dhe jo pak herë ia dilte. Po ishte ende e vogël për të kuptuar se kjo rendje, ky shpirt gare nuk kishte të bënte me futbollin, por me një tjetër sport që do të bëhej më vonë kuptimi i jetës së saj, atletikën. Kështu nisi marrëdhënia e Luizës së vogël me vrapimin. Dilemat e rritjes do t'i shuante përfundimisht në përfundim të shkollës 8-vjeçare. Kur të gjithë vendosën të regjistroheshin në gjimnaz, ajo nuk u mendua dy herë. Zgjodhi të bëhet nxënëse e Mjeshtërisë Sportive në Durrës. Nga ky çast vrapimi nuk ishte më një "lojë hokatare" mes djemsh. Vrapimi u kthye në një qëllim dhe synim të madh: një ditë të radhitej përkrah kampionëve që aq shumë e frymëzonin dhe e bënin të ëndërronte. Por rruga sa kishte filluar dhe rruga e sportit nuk është kurrë e lehtë. Fitoret gjithashtu nuk janë të lehta. Kurse dështimet në sport lënë gjurmë të pakthyeshme. Pista e vrapimit u bë shtëpia e saj e dytë. Edhe kur muskujt i lodheshin nga terreni i vështirë, edhe kur i duhej të vraponte në mjedis të hapur, në shi e në të ftohtë, edhe kur pas një fitoreje nuk gjente mbështetjen e dëshiruar ajo kurrë nuk u spraps, por përsëri vraponte. Luiza kishte një ëndërr. Ëndrrën e kampiones, që kërkonte ta kthente në një gjë reale, të kapshme. Orë të tëra stërvitjesh dhe besimi në fitore nuk e "vonuan" ardhjen e titullit kampion. Dhjetë vjet më parë, kur do të shpallej kampione për herë të parë, ajo do të "shënjohej" si një prolog për arritje të tjera.

Me përfundimin e shkollës dilemat e së ardhmes do ta trondisnin pak. Kishte arritur të bëhej një sportiste me emër dhe në duar mbante diplomën e Universitetit të Sporteve. Po cila do të ishte e ardhmja e saj? Do të niste punë diku si mësuese e edukimit fizikë apo do t'i duhej të zgjidhte një tjetër profesion, që ndoshta pak lidhje kishte me sportin? Asgjë nuk ishte e sigurt, por njëkohësisht kjo nuk e thyente aspak dëshirën e saj të brendshme që të vijonte rrugën që kishte nisur dhe të të ishte një sportiste elitare. Në sport veç emrit të kampiones kishte fituar shumë miq e kolegë të mirë. Një ndër ta ishte dhe Gerard Qirici, major i FA Shqiptare dhe pjesë e Policisë Ushtarake, edhe ai një sportist i talentuar. Gerardi ishte i pari që i tërhoqi vëmendjen Luizës për të bashkuar sportin me uniformën ushtarake. Dhe kjo tërheqje nuk ishte fare e pakuptimtë. I kishte ndodhur që gjatë pjesëmarrjeve në gara të ndryshme jashtë vendit, kolegët e saj atletë t'i shihte të veshur me uniforma ushtarake, të vendeve që ata përfaqësonin. Një praktikë e njohur kjo në Lindje e Perëndim, që sportistët elitarë të përfaqësojnë Forcat e Armatosura. Mes hezitimit të zëvendësimit të uniformës sportive me uniformën ushtarake, duket se te Luiza fitoi kjo e dyta. Nuk është se e pati të kollajshme që gati pas 20 vjetësh me tuta, ta shihte veten të veshur me uniformën e Policisë Ushtarake, si një Ushtare Profesioniste e Parë. Por për një gjë u ndje mirë: në Forcat e Armatosura, në Policinë Ushtarake kishte gjetur mbështetjen e munguar. Së pari, jo vetëm një mbështetje materiale aq e nevojshme për një jetë cilësore për një sportist, por mbi të gjitha mbështetjen morale, ngrohtësinë e njerëzve me të cilët ndan punën e përditshme dhe arritjet në sport. Një mbështetje që nis që nga përkujdesja personale e ministres së Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli. Tashmë Luiza do të ishte një përfaqësuese e denjë edhe për Forcat e Armatosura. Krahas kupave dhe medaljeve ajo tregon certifikatën e mirënjohjes marrë pikërisht nga Ministria e Mbrojtjes. Kompeticionet e saja nuk janë më një nismë individuale, atyre u është shtuar edhe përfaqësimi i FASH në rang vendi dhe ndërkombëtarë. Si përfaqësuese e ushtrisë shqiptare ajo ka marrë pjesë në kauza të mëdha humanitare. Në maratonën që u zhvillua në kuadër të luftës kundër kancerit të gjirit përreth kodrave të Liqenit Artificial, përfaqësuesja e Policisë Ushtarake dhe atletja e mirënjohur Luiza Gega ishte e para që me moton "Vrapo drejt jetës" udhëhoqi qindra vrapuese, pjesëtare ose jo të FA, duke përcjell mesazhin e jetës dhe sensibilizuar gratë dhe vajzat në vendin tonë për rritjen e kujdesit të jetës dhe shëndetit të tyre. Vajza e brishtë me forcën e madhe, është një ikonë në radhët e Policisë Ushtarake. Ajo e ndien këtë çdo mëngjes, kur paraqitet në repart, e prek tek përkujdesi i komandant Xhevdetit, tek marrëdhënia me kolegët sportistë, tek çastet që ndan me mikeshat e saja ushtarake. Por ajo ngelet padyshim një model frymëzues për të gjitha vajzat sportiste, që krahas sportit duan të ndërtojnë një karrierë në radhët e Forcave të Armatosura. Vetë Luiza e sheh të gjatë rrugëtimin e saj mes sportit dhe të qenurit ushtarake. Natyra dhe karakteri i saj i fortë duket sikur e inspirojnë të ndërmarrë sfida më të mëdha sesa sporti. E sheh veten të përfshirë në misionet e mbrojtjes, ndoshta edhe jashtë vendit. Sepse ajo është një sfidante e lindur. Pas çdo arritjeje kërkon një tjetër. Tashmë ia ka arritur të jetë sportiste profesioniste, ushtare profesioniste dhe dëshiron të shoh të tjera yje t'i shtohen supeve të saj që duken delikat, por janë të aftë të mbajnë përgjegjësi të mëdha. Luiza është shembulli se me punë mund të arrihet gjithçka, është model i vënies së arritjeve në shërbim të atdheut, sepse medaljet e Luizës nuk janë vetëm krenaria e saj, janë krenaria e ushtrisë sonë, janë krenaria e Policisë Ushtarake ku punon, janë krenaria e vajzave dhe grave që ajo përfaqëson si ushtarake. E gjendur mes veprimtarive të përditshme në repart, ku pjesën më të madhe e dominojnë veprimtaritë sportive dhe stërvitjes Luiza dallon për modestinë e saj. Për miqësinë e sinqertë që e spikat si vlerë. Për virtytin e mirënjohjes që nuk rresht së shprehuri duke filluar nga kolegu i zakonshëm e deri në shkallën më të lartë të hierarkisë ushtarake. Pikërisht mbështetja që gjen i jep forcë për arritje të reja. Planet e së ardhmes janë ravijëzuar tashmë. E pret një garë e vështirë në Korenë e Jugut, ku nuk do të jetë thjesht atlete, por përfaqësuese e FA të Republikës së Shqipërisë, në olimpiadën botërore të ushtrive nga gjithë bota. Për këtë po stërvitet fort. Sepse dëshiron që të shoh në podium mes flamujve të tjerë edhe flamurin tonë me shqiponjën dykrenare.

Luiza atlete dhe ushtarake e Forcave të Armatosura, po lë pas një 2014 plot suksese. Dhe sukseset e saja nuk janë aspak rastësore. Janë fryt i një pune këmbëngulëse dhe një mbështetje qoftë nga Komiteti Olimpik Shqiptar, ashtu edhe nga Ministria e Mbrojtjes. E tillë ishte edhe bursa për t'u stërvitur në Kenia, atdheun e atletëve të mëdhenj me famë botëtore. Për të kuptuar se çfarë përfaqëson sporti për Luizën, mjafton vetëm një mëngjes apo mbasdite ta ndjekësh atë në stërvitje dhe sheh se shpirti i saj luftarak është i paepur. Tek i bie papushim pistës së stadiumit "Qemal Stafa", apo tek garon në stadiumin e Korçës, me Moravën e mbuluar nga dëbora përballë, silueta e saj që herë largohet e herë afrohet i ngjan një shqiponje, që ngjitet lart e më lart drejt majave. Kjo është Luiza, atletja ushtarake, që festat e fundvitit i pret në stadium, me një dëshirë të vetme: Ta ngrejë sa më lart emrin e Forcave të Armatosura Shqiptare dhe të atdheut të saj, pikërisht aty, në pistën e vrapimit, në shtëpinë e saj të dytë.

Një vit pa Riza Lahin, pilotin dhe poetin shpirtmadh...

MUHARREM DARDHA

Teksa ditët e këtij viti po ikin si pa u ndjerë, nuk di pse shpesh kam kujtuar pilotin poet, shkrimtarin dhe publicistin, shokun dhe njeriun e mirë, Riza Lahin, i cili mbylli sytë dhe u largua nga kjo jetë pikërisht më 31 dhjetor të vitit 2013. Ka kaluar një vit dhe mendimi se Rizai është gjallë, që një zile e telefonit të tij do të më ftojë për një kafe tek "Agolli" apo që do ta has diku në një nga rrugët e shumta të Tiranës nuk më është shqitur. Ja, kështu të ndodhkërka për një njeri që të dukej i pavdekshëm, i kudondodhur, plot gaz e humor, siç ishte Riza Lahi. Ndaj, atë pasdite të ftohtë fund dhjetori të shkuar, si unë dhe shumë shokë e miq të tij (Sa shumë të tillë kishte ai!), gati jemi shokuar ku mësuam lajmin e vdekjes kaq të papritur dhe kaq befasuese…

Me Riza Lahin jam njohur tri dekada e ca më parë, kur ai si pilot i aviacionit shqiptar fluturonte hareshëm nëpër qiellin shqiptar dhe shkruante e botonte vjersha dhe reportazhe të bukura e plot jetë në shtypin tonë ushtarak dhe në atë të përditshëm. Por njohja jonë u thellua së tepërmi sidomos nga fillimviti 2002, kur së bashku punuam në revistën "Mbrojtja". Ishte vërtetë një kohë që mund ta quaj si një nga periudhat më të bukura të jetës. Kjo nuk është aspak ekzagjerim që e shënjoj tani kur ai nuk është më midis nesh, por këtë e thoshim që atëherë. Mezi prisja ta takoja në mëngjes, ta shihja që nga larg ashtu të qeshur e me flokë të shpupurishur teksa ecte mbi biçikletën e tij gati proverbiale, të pinim fillimisht kafen e mëngjesit tek "Agolli" duke tymosur edhe nga një cigare që ai na e zgjaste aq bujarisht dhe pastaj të nisnim punën për përgatitjen e numrit të ri të revistës, të cilës ai i gëzohej si një fëmijë…Janë të panumërt reportazhet, shkrimet problemore, intervistat që ai botoi në ato vite në organet e shtypit ushtarak, ku me një stil elegantë dhe gjuhë të përzgjedhur sillte jetën e ushtarakëve që shërbenin anekënd atdheut, në misionet paqeruajtëse në Irak, Gjeorgji, Bosnje-Hercegovinë etj. Shkrimet e tij ngjisnin menjëherë sepse ai "brumin" e tyre e merte tek ushtarët dhe oficerët e thjeshtë që takonte në fushat e stërvitjes, në vëndrojet e shërbimit, në operacionet në ndihmë

"Rizai, njëri i gjallë, i sinqertë si askush, është poet dhe përkthyes, eseist i fluturimeve. Rrallë kam takuar njëri që i do kështu Shqipërinë dhe njerëzit e thjeshtë..." Kështu shkruan studiuesi dhe shkrimtari i mirënjohur Moikom Zeqo në parathënien e njërit prej më se 30 e ca librave që na ka lënë Riza Lahi.

KUSH ËSHTË RIZA LAHI?

Riza Lahi lindi në Shkodër më 16 tetor 1950. Për tridhjetë vite shërbeu si pilot në Forcat Ajrore të vëndit, më pas gazetar në shtypin ushtarak, si dhe disa kohë pranë Zyrës së OSBE-së në Tiranë. Është autor i mbi 30 librave, përfshi këtu romane, monografi, vëllime me tregime, publiçistikë, përkthime etj. Pjesë nga krijimtaria e Riza Lahit janë botuar edhe në Zvicër, Greqi, SHBA, Iran, Rumani, Indi, Sllovaki, Çeki, Korea e Jugut, etj. Në konkursin kombëtar në vitin 1994 ka fituar vëndin e parë në Republikë me pjesën teatrale për fëmijë, botuar më pas nën titullin "Të shtunën në mesnatë në një yll". Ka fituar edhe çmime të tjera të niveleve të ndryshme, si edhe ka botuar pandërprerë në shtypin e përditshëm, duke ruajtur me kujdes pozicionin e publicistit dhe të shkrimtarit të pavarur. Prej shumë vitesh ishte anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, anëtar i Kongresit të "IËAA" (Shoqatës Botërore të Shkrimtarëve dhe Artistëve), anëtar i i Shoqatës Botërore të Poetëve (Ëorld Poet Society-ËPC) etj.

VEPRA TË BOTUARA

Tregime, përralla për fëmijë:
"Legjenda e Zerdelisë", 1985
"Ledia në një natë me hënë", 1995
"Aventurat e rosës Monda", (shqipërim nga E. Bosse) 2001
Vëllime me poezi & tregime:
"Kosova, e fejuara ime", 1994
"Drenica, qeleshja kosovare", 1998
"Trëndafila nga Tirana", 2009
Tregime:
"Ëngjëjt me krahë duralumini", 2000
"Fluturime mbi qilimin persian", 1998
"Nën hënën e Ulqinit", 2001
"Ylli që sheh mbi sheshin "Skënderbej", 2001
Romane:
"Të shtunën në mesnatë në një yll", 1997, roman për fëmijë
"Vorri i Ashikut", në katër volume, 2005
"Serenatë korçare në Nju Jork", 2009
Biografi artistike:
"Një violinë në Panteoinin e Orfeut", 2008
"Dinosaurët e fundit", 2003
"Maratonomaku nga Shkodra", 2008
"Piloti i katër presidentëve"
Shqipërime:
"Poezi për fëmijë nga vëndet anglishtfolëse", (dy vëllime) 2006
"Mbrëmë i pëshpërita një Ylli", poezi nga Xhelaludin Rumi 2002
"Fluturoi qielli nga cepi i vendit tim", poezi nga F. Forughazd 2006
"Golgota shqiptare" nga Leo Freundilch, 1990
"Ikja massive", nga Hans Peter Rulmann 1997
"Ëngjëlli i Mostarit", nga Sally Becker 2000 etj.

të popullsisë civile të zonave që përmbyteshin nga reshjet apo që izoloheshin nga dëbora. Ai ishte i papërtueshëm, gjithnjë në kërkim të së panjohurës, të së bukurës, pozitves. E vaçantë në atë kohë në revistën "Mbrojta" u bë rubrika e intervistave me atashetë ushtarak të akredituar aso kohe në vendin tonë, ide kjo e realizuar nga vetë Rizai… Dhe përsëri vinin ndarjet dhe takimet, bisedat dhe diskutimet e pafund me të për problematikat e kohës, për letërsinë dhe krijimtarinë, për miqtë e tij pilotë që aq shumë i kujtonte, për Shkodrën dhe nënë Shemsien e tij të dashur atje në "Zdralen" e vjetër, shakatë dhe emocionet e panumërta që ai na falte pa pushim. Për të mos u ndarë më kurrë edhe gjatë gjithë kësaj dekade të fundit të jetës së tij…

Më pëlqen të them se Riza Lahi ishte një qenie njerëzore e rrallë. Ai gjatë gjithë jetës së tij vështirë se mund të ketë bërë armiq, shpirti i tij nuk njihte ligësi, urrejtje, mëri apo smirë. "Rizai, njëri i gjallë, i sinqertë si askush, është poet dhe përkthyes, eseist i fluturimeve. Rrallë kam takuar njëri që i do kështu Shqipërinë dhe njerëzit e thjeshtë…". Kështu shkruan studiuesi dhe shkrimtari i mirënjohur Moikom Zeqo në parathënien e njërit prej më se 30 e ca librave që na ka lënë Riza Lahi. Fjala është për "Dinosaurët e fundit", në të cilin Rizai ka përshkruar aq bukur portretet e dhjetëra e dhjetëra shokëve të tij pilotë, të kësaj specie të rrallë, që siç thoshte ai, vështirë se mund t'i vijnë kaq madhërishëm kombit tonë…Kështu edhe për figurat e ndritura të sportit të Shkodrës loce, për njerëzit në nevojë, për romët, për të rënët në luftën për çlirimin e Kosovës…Prandaj dhe është vështirë të gjendet një njeri, i cili t'u mungojë të gjithëve me vdekjen e tij dhe vështirë të gjendet një njeri që e ka njohur Riza Lahin, Xaken tonë të shtrenjtë, dhe të mos jetë hidhëruar për të.

***

Po e mbyll këtë in memoriam për Riza Lahin, duke përcjell dy strofa nga poezia "Kur të vdes" e poetit të madh pers, Rumiut, poetit që aq shumë e adhuronte Rizai dhe që kishte përkthyer e botuar në shqip poezitë më të mira të tij. Kjo poezi i shkon shumë edhe tani që ai prehet në botën e amshimit.

Kur të vdes,
kur qefini im të dalë në portë,
mos mendoni,
se kam ikur nga kjo botë.
Kur të shihni trupin tim të ngurosur,
mos vajtoni ikjen time.
nuk po iki,
po mbërrij në dashurinë e pasosur.

Po, miku ynë i shtrenjët Riza. Ti nuk ke ikur, ti ke mbërritur në Dashurinë e Pasosur!

Poezi nga Riza Lahi

Nëna ime

Të lutem,
Rro edhe pak,
Se ndryshe
Sa herë të shfaqem
Te ura e Bahçallëkut,
Ajo do të tronditet shumë,
Unë do të përkulem mbi ujrat e Drinit të shpërlaj lotët.
Rozafa
Do të më shikojë akoma më shumë me dhimbje,
Ajo është mësuar të më shikojë duke qeshur,
Duke kënduar mbi urë,
Duke lustruar këpucët, duke fshirë pluhurin, duke u krehur
Para se të hyj në qytet.

Rro edhe pak nëna ime,
Që unë të jem ende djalë shtëpie përmbi këtë urë,
Jo mysafir i largët,
I largët dhe i përlotur.

Pilotët e vjetër

Hodhën nga një grusht
dhe në varrrin e hapur
ku qanin të gjithë.
Iu afruan të heshtur tavolinës së mortit.
U ulën,
Pikëlluan ca,
Pinë dhe nga pakëz raki
Dhe bënë shaka.

Kishin luajtur me vdekjen
tër jetën.

Unë ua njoh të gjithëve:
Mëritë,
Djallëzitë,
Modestitë,
Egoizmin,
Pisllëqet,
Furinë,
Plogështinë
Fuqinë
Dobsinë
Të qeshurat
Lotët

Që të gjithë këta
E patën një të dashur,
Që i treguan gjithëçka,
Që i falën gjithëçka,
Që i qeshën gjithëmonë,
Që nuk e tradhëtuan kurr...

Hapsirën mbi atdhe.

Dalëngadalë...

Rrugët...
E ndjej,
kanë nisur të më presin
përditë dhe më ftohtë.

Po ec nëpër rrugët e qytetit më të panjohur të botës,
nëpër rrugët e qytetit tim.
Vetëm ujrat nuk më paskan harruar
Dhe shokët e fëmijërisë,
Të mplakur që të gjithë
Dhe që kthehen në adoleshëntë menjëherë,
Si ujrat e Drinit
Sapo nisin papritur shirat.

Lamtumirë

Ledias, me rastine mbarimit të maturës, kujtim nga babai
Lamtumirë gjimnazi im "Qemal Stafa",
Lamtumirë mësues, shokë, ti, banka ime,
Kushedi hapat e mi, kur do m'i ndjeni prap,
Hapat e vajzës që notonte në ëndërrime.

Mësuesit e mi, gjer të mësoheni pa mua,
Do pyesni njëri-tjetrin, po... ku shkoi?
Me aromë mimozash do përgjigjet pranvera:
E katërta shtatë dhe…ajo,…oh…fluturoi!

Po kur një ditë do më keni harruar,
Qemalsja juaj do të vijë te dera,
Ngadalë, hutuar, do të ngjitet te shkallët
E drejt te banka ku rrinte përhera

Në mos paça me vete t'u sjell lule,
Të freskëta, të bukura siç i rrit saksia,
Të rrahura zëmre do t' dhuroj pafund,
Dhe lule të zbehta nga thinjat e mia.

Do të pyesë roja plak, ku e kam parë
Këtë zonjë që s'qesh si nxënësit e tjerë?
Do t'i them:më lër, më lër të hyj, o plak,
Qemalse edhe unë kam qënë një herë...

Ushtarakë të shquar të Ushtrisë Shqiptare në vite

Bajram Mana, përfqaësues i denjë i një brezi të shquar në FA

KOL. (R) ZYHDI KROJ,
KOL. (R) HYSNI MULLALLI

Në gjerdanin e gjatë të emrave të ushtarakëve që kanë dhënë kontribute të veçanta në Forcat e Armatosura, padyshim mund të veçohet koloneli në pension Bajram Mana, i cili në këtë përvjetor të 70-të Çlirimit të vëndit, pikërisht në nëntor, festoi 70-vjetorin e lindjes. Ai lindi në në Librazhd, në një familje me tradita atdhedashurie dhe patriotike, cilësi të cilat ai jo vetëm i ruajti, por dhe i zhvilloi ato në një nivel më të lartë. Shkollën fillore dhe 7-vjeçare i mbaroi në vëndlindje. Në vitet 1958-1962 përfundoi shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej", në vitet 1962-1964 Shkollën ë Bashkuar të Oficerëve me rezultate të shkëlqyera dhe në vitin1972-1974 përfundoi Akademinë Ushtarake, po me rezultate të shkëlqyera.

Bajram Mana e filloi karrierën ushtarake nga komandant toge dhe i ngjiti shkallët e saj një nga një, vetëm me vullnet, punë dhe përkushtim, pa pasur asnjë mbështetje dhe ndërhyrje nga lart. Me aftësitë e tij arriti deri në majën e piramidës ushtarake të Ushtrisë Shqiptare. Midis detyrave të kryera gjatë karrierës së tij ushtarake, mund të shënojmë, atë të komandantit të Brigadës në Patos; zv.drejtor i Drejtorisë Operative në Shtabin e Përgjithëshëm; komandant i Korpusit të Korçës; zn.ministër i Mbrojtjes dhe zv.shef i Shtabit të Përgjithëshëm, komandant i Divizionit dhe i garnizonit të Tiranës. Janë të rrallë ushtarakët që kanë pasur këtë karrierë dhe këtë ekperiencë në ushtri. Baza kryesore e karrierës të tij brilante kanë qënë morali i lartë dhe ndershmëria, profesionalizmi, disiplina dhe korrektësia, kërkesa e lartë e llogarisë, përgjegjësia në detyrë, puna në grup dhe komunikimi me vartësit kolegët dhe eprorët, të cilat janë pjesë përbërëse e karakterit të tij.

Gjithkush që ka punuar me këtë ushtarak karriere me lehtësi konstatonte se ai ishte një komandant ekselent dhe me aftësi të rralla organizuese, drejtuese e komanduese. Bajrami gjatë gjithë karierrës te tij ka vërtetuar se njëherazi ishte një intelektual dhe reformator nga më të shquarit në Forcat e Armatosura. Vetë karrierra e kolonel Bajramit nga nivelet e ulta deri në nivelet më të larta, flet qartë për faktin që ai ka qënë një kuadër me aftësi të larta ushtarake, një njohës i shkëlqyer i stërvitjes dhe i Artit Ushtarak, ku në mënyrë të veçantë ka spikatur niveli i lartë i drejtimit dhe komandimit të nënreparteve, reparteve, njësive taktike, njësive operative dhe deri ne Shtabin e Përgjithëshëm dhe Ministrinë e Mbrojtjes. Puna e tij

Bajram Mana e filloi karrierën ushtarake nga komandant toge dhe i ngjiti shkallët e saj një nga një, vetëm me vullnet, punë dhe përkushtim, duke arritur deri në majën e piramidës ushtarake të Ushtrisë Shqiptare

është vlerësuar në maksimum dhe këtë e vërteton karierra e tij gjithmonë në rritje dhe dekorimi me tre urdhra dhe katër medalje për shërbime të shquara në Ushtrinë Shqiptare.

Bajram Mane është ideatori dhe autori i shumë materialeve teorike dhe metodikave, ka qënë drejtuesi i suksesëshëm i shumë stërvitjeve si: stërvitje shtabi; stërvitje komandoshtabi; stërvitje me trupa; stërvitje dhe mësimeve treguese në shkallë brigade, korpusi dhe ushtrie, si në drejtim të stërvitjes dhe gatishmërisë. Ai është një nga njohësit më të mirë të problemeve të gatishmërisë dhe veçanrisht të detyrave komplekse të planizimit luftarak të të gjitha niveleve të Forcave të Armatosura. Krahas profilit të tij si një ushtarak model shquhej edhe disa tipare të tjera dalluese në raport me vartësit, kolegët dhe eprorët. Ai kishte vullnet, kurajo dhe guxim gjatë përmbushjes të detyrave të ngarkuara, por dinte edhe të komunikonte, nxiste mendimin dhe debatin, dëgjonte dhe vlerësonte mendimet e vartësve. Bajrami ishte i qartë dhe i prerë në dhënien e detyrave dhe urdhrave të ndryshme, ishte një orator i vërtetë dhe kishte një terminologji të pasur ushtarake. Gjithashtu ai shquhej edhe për një aftësi dhe prirje për të shkruar. Materialet teorike, metodikat, raportet, urdhrat dhe informacionet e tij rrezatonin kulturë ushtarake dhe komptencë profesionale.

Një dhunti e veçantë e Bajram Manes gjatë gjithë karrierës së tij ishte dhe ana njerëzore, gjykimi i shëndoshë dhe thjeshtësia. Ai i dëgjonte dhe i respektonte vartësit e tij, u qante hallet dhe angazhohej maksimalisht për zgjidhjen e problemeve të tyre shëndetësore, të strehimit, të transferimeve, të punësimit të familjarëve të tyre etj.

Pas daljes në rezervë, në maj të vitit 1992, ai ka qënë një nga krijuesit dhe drejtuesit kryesor të Shoqatës së Ushtarakëve dhe ka luftuar pa u lodhur për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të ushtarakëve dhe familjeve të tyre. Ai ka vënë në shërbim të shoqatës të ushtarakëve gjithë autoritetin dhe reputacionin e tij duke lobuar në të gjitha institucionet shtetërore për të fituar të drejtat ekonomike dhe ligjore të ushtarakëve. Sot Bajaram Mana është një nga nismëtarët kryesor që po bën përpjekje maksimale për bashkimin e ish-ushtarakëve në një shoqatë të vetme mbarëkombëtare. Në këtë përvjetor të 70-të të lindjes të tij, shokët, kolegët, miqtë dhe bashkëpuntorët e tij, përveç urimit të përzemërt, vlerësojnë figurën e Baram Manes si një ushtarak të denjë të atij brezi që transformoi, zhvilloi, modernizoi dhe drejtoi me kompetencëë Forcat e Armatosura për përmbushjen me sukses të misionit të tyre kushteteues, mbrojtjen dhe garantimin e sigurisë të atdheut dhe popullit.

NJOFTIM

Për kriteret e përgjithshme për rekrutimin e ushtarëve/ detarëve aktiv:

a). Për t'u rekrutuar në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë si ushtar/detar aktiv shtetasit shqiptarë duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale;
- Të mos jetë në ndjekje penale;
- Të mos ketë humbur të drejtën e ushtrimit të profesionit ose veprimtarisë në administratën publike me vendim gjykate;
- Të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata;
- Mosha minimale e rekrutimit është 18 vjeç. Në momentin e titullimit ushtar/detar aktiv, nuk duhet të kenë mbushur moshën 27 vjeç. Përjashtim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen ushtar/detar aktiv, të cilët do të jenë personel mjekësor i Forcave të Armatosura dhe në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç;
- Të ketë kryer arsimin parauniversitar ose të lartë brenda ose jashtë vendit;
- Të ketë kryer kontrollin shëndetësor dhe të jetë vlerësuar i aftë për ushtar/detar aktiv nga Spitali Ushtarak i FA në Komandën Mbështetëse;
- Të ketë kaluar testin fizik, intelektual dhe psikologjik;
- Kandidatët për ushtar/detarë aktiv të kenë gjatësinë trupore mbi 170 cm për meshkujt dhe mbi 165 cm për femrat;
- Kandidatët për ushtar aktiv të planifikuar për kompletimin e Policisë Ushtarake duhet të kenë gjatësinë trupore mbi 170 cm për meshkuj dhe femra.

b). Për rekrutimin sipas specialiteteve të veçanta, veç këtyre kritereve të aplikohen edhe kritere specifike për aftësitë profesionale dhe parametrat fizikë, të cilat përcaktohen me një udhëzim të veçantë të SHSHP.

Procedura e aplikimit për ushtar/detar aktiv:

a) Shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në Forcat e Armatosura si ushtar/detarë aktiv do të aplikojnë drejtpërdrejtë në zyrën e pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit.

b) Aplikantët plotësojnë formularin e aplikimit dhe pranimit të dokumentacionit (bashkëlidhur këtij udhëzimi) dhe marrin njoftimin për dokumentet e nevojshme, afatin e paraqitjes në Qendrën e Personel Rekrutimit për vijimin e procesit të pranimit, testimit e përzgjedhjes.

c) Procedurat, kriteret, rregullat e testimit bëhen publike në faqen e internetit të Forcave të Armatosura.

Regjistrimi i kandidatëve, dokumentacioni i nevojshëm:

a) Kandidatët për ushtar/detar aktiv paraqesin në Qendrën e Personel Rekrutimit dokumentet e mëposhtme:
- Kërkesë me shkrim, në të cilën parashtrohet identiteti i aplikantit, statusi familjar (martuar, beqar), arsyet për të cilat dëshiron të bëhet ushtar/detar aktiv, njësia apo reparti në të cilin do të dëshironte për të shërbyer. Aftësitë, përvoja në punë, prirjet e tij në fusha të caktuara, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi (formulari i aplikimit);
- Fotokopjen e kartës së identitetit;
- Certifikatë familjare;
- Dy fotografi të përmasave 4 x 6cm dhe dy fotografi të përmasave 9x12 cm;
- Fotokopje të diplomës së arsimit parauniversitar ose të arsimit të lartë të noterizuar dhe të vërtetuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale/Rrethit;
- Diplomë, dëshmi, certifikatë për aftësitë profesionale (nëse ka), të noterizuar;
- Dëshmi penaliteti;
- Vërtetim nga prokuroria;
- Vërtetim nga gjykata;
- Fletë të ekzaminimit mjekësor nga Spitali Ushtarak i FA në Komandën Mbështetëse.

b) Periudha e regjistrimit: 1 dhjetor 2014 deri më 14 janar 2015.

Adresa:
Qendra e Personel Rekrutimit, Rruga e "Dibrës"
(Ish-Shkolla e Bashkuar), Tiranë.
Kontakt:
++ 355 69 88 01 195

UNÇL Shqiptare në ndihmë për çlirimin e Kosovës dhe popujve të ish-Jugosllavisë gjatë LIIB

Populli shqiptar kurrë nuk e ka kursyer ndihmën e tij për këdo e në mënyrë të veçantë për fqinjët

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Veprimet luftarake të njësive partizane përtej kufijve shtetërorë kanë filluar nga mezi i vitit 1942 për çlirimin e Kosovës dhe në ndihmë të popujve të Jugosllavisë. Duke u nisur nga karakteri i tyre, nga forcat pjesëmarrëse dhe nga koha e vendi në të cilin u zhvilluan, ato kanë kaluar nëpër disa periudha. Kështu nga viti 1942 dhe deri në muajin gusht 1944 është periudha fillestare, ku repartet partizane herë pas here në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi, kanë goditur përqëndrimet dhe autokolonat e fashistëve italianë, të nazistëve gjermanë dhe kthimin e tyre përsëri në bazat e tyre brenda kufijve shtetërorë. Veprimet luftarake ndërmerreshin me iniciativën e vet shtabeve të reparteve partizane, duke i'u përmbajtur kriterit se fashizmi është armiku i të gjithë popujve. Kështu reparteve partizane, si çeta e Tropojës, çeta e Dibrës, batalioni "Bajram Curri", batalioni "Perlat Rexhepi" batalioni i Dibrës, batalioni i Martaneshit, batalioni territorial "Rinia" i Tropojës, Br. I S, Br. IV S në bashkëveprim edhe me repartet partizane të Kosovës, Maqedonisë kanë kryer aksione të përbashkëta.

Veprimtaria luftarake e Divizionit V S

Periudha intensive fillon nga shtatorit 1944 ku Br. III S dhe Br. V S me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm kaluan në Kosovë. Këto brigada në bashkëveprim me repartet kosovare, plotësuan detyrën luftarake më 20 nëntor 1944 dhe morën urdhër për veprime të tjera. Periudha mësymëse fillon nga 22 nëntor 1944, ku Div. V dhe VI S morën urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm, në bashkëveprim me repartet e Ushtrisë Jugosllave të ndiqnin dhe të asgjësonin nazistët gjermanë në thellësi të tokave të Jugosllavisë dhe përfundon më 4 shkurt 1945 me çlirimin e Vishegradit. Deri në gusht të vitit 1945 ka vazhduar periudha kur forcat partizane u kthyen përfundimisht në atdhe. Periudha përfshin si veprimet luftarake në Kosovë, Metohi e Maqedoni kundër bandave reaksionare të çetnikëve, por dhe punën e madhe të gjithanshme që bënë repartet partizane shqiptare me popullsinë vendase. Kjo luftë e reparteve të ushtrisë partizane shqiptare përtej kufijve shtetërorë, është veprimtaria më bindëse dhe provon se populli shqiptar dhe njësitë partizane plotësuan me dinjitet dhe drejtësi detyrën e tyre ndaj koalicionit antifashist të kryesuar nga Anglia-Bashkimi Sovjetik dhe SHBA në përgjithësi dhe ndaj popujve fqinjë në veçanti.

Në bazë të kërkesës së Komandës së Përgjithshme Jugosllave dhe në interes të detyrave të shtruara Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Shqiptare, në shtator 1944, u urdhëruan që Br. III, V S të kaloni në Kosovë. Më 5 tetor 1944 këto brigada kaluan kufirin shtetëror dhe filluan përleshjen me fashistët gjermanë në Rrafshin e Dukagjinit, çliruan zonën midis Drinit dhe Ribnikut dhe më 16 tetor sulmuan gjermanët në qytetin e Gjakovës. Përballë një kundërshtari të madh në forca e në mjete me luftime të ashpra, në bashkëpunim me repartet partizane kosovare çliruan më 24 tetor Junikun, më 5 nëntor Deçanin, më 7 nëntor Gjakovën, më 16 nëntor Prizrenin dhe më 17 nëntor Pejën duke i dëbuar gjermanët nga Rrafshi i Dukagjinit e nga Kosova.

Populli i Kosovës i priti me ngrotësi partizanët shqiptarë, duke u ngritur më me vrull në luftën kundër pushtuesve gjermanë e reaksionit vendas. Në këtë kohë u krijuan dy brigada të reja partizane kosovare, që së bashku çliruar Kosovën e Rrafshin e Dukagjinit. Detyra shtrohej që të ndiqeshin divizionet gjermane në thellësi të territorit të Jugosllavisë për t'i rrethuar e asgjësuar ato në bashkëveprim me ushtrinë jugosllave e forcat e koalicionit antifashist. Me krijimin e Div. V S në përbërje të të cilët hynjnë dhe Br. III, V, XXV S, u kalua në një shkallë më të lartë organizimi. Kërkohej drejtim operative-strategjik i luftës partizane me atë frontale.

Me hedhjen e njësive të reja në ndihmë të çlirimit të popujve të Jugosllavisë, filloj një etapë e re e Veprimet luftarake të forcave partizane përtej kufijve shtetërorë, hynë në një etapë të re. Karakteristikë u bë shumëfishimi i forcat pjesëmarrëse dhe duke rritur karakterin mësymës të veprimeve luftarake. Zona e veprimeve luftarake shtrihej në trekëndëshin: Mitrovicë-Ulqin-Vishegrad dhe mision i tyre ishte serioz dhe i vështirë. Forcat partizane shqiptare kalonin në një terren të panjohur, të thyer malor, të ngarkuar me dëborë etj. Fshatrat e qendrat e banuara ku zhvilloheshin veprimet luftarake, ishin të djegura e të shkatërruara nga nazistët, të varfra ekonomikisht dhe kishte vështirësi në furnizimin me ushqim të tyre. Furnizimi me municion ishte i kufizuar dhe ai sigurohej në fushat e betejave dhe në depot e armikut. Pavarësisht vështirësive dhe pengesave të shumta të dala nga shtabet dhe repartet jugosllave, partizanët shqiptarë e plotësuan me sukses detyrën e ngarkuar. Div. V S mori detyrë që pas një marshimi të gjatë të mësynte forcat e dy divizioneve të Korparmatës 21 gjermane të Grup Armatës "E", që ishin përqendruar në trikëndëshin Priepolje-Rudo-Vishegrad. Në javën e parë të dhjetorit forcat e Div. V S ishin gati për marshim. Br. XXV S ndërkohë kreu marshimin Gjakovë-Ferizaj 80 km për t'i shkuar në ndihmë Br. II Maqedonase që ishte e rrethuar.

Më 2 dhjetor 1944 Br XXV S çliroi qytetin e Ferizaj bashkë me fshatrat përreth saj. Deri më 17 dhjetor, pasi kishte bërë një marshim të sforcuar prej rreth 200 km nga Mitrovica, forcat kryesore të Divizionit arritën në lindje të Sanxhakut, ndërsa Br XXV S vazhdonte marshimin pas tyre. Në Sanxhak shtabi i Divizionit mori kontakte me divizionet jugosllave dhe të dhënat e tjera nga zbulimi dhe njohu gjendjen e armikut që kishte përballë. Në brezin e mësymjes së Div. V S forcat gjermane e kishin organizuar mbrojtjen në tri vija duke i përqendruar forcat e mjetet kryesore në të dy krahët e rrugës automobilistike Senicë-Priepolje ku kishin ndërtuar 15 pikëmbështetje të përgatitura mirë, për të luftuar dhe për të jetuar rreth 100 forca për secilën. Më 18 dhjetor 1994 shtabi i Div. V S nga vendkomanda në Senicë lëshoi urdhërin e parë luftarak për mësymje duke pasur në skalion të parë Br. III dhe V S dhe në skalon të dytë Br. II dhe V S.

Viti i ri 1945 e gjente atdheun tonë të çliruar, ndërsa partizanët e Div. V dhe VI S i gjeti duke sulmuar pa pushim armikun. Për luftimet e ashpra të javës së parë të janarit, me një komunikatë të datës 6 janar, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Jugosllave, pas një heshtje të gjatë, pohonte: "Njësitë e UNÇSH janë shquar në mënyrë të veçantë gjatë këtyre luftimeve (në luginën e lumit Lini). Orvajtjet e armikut për të çarë rrugën drejt Jadovikut nuk patën sukses". Forcat e Div. V S thyen përfundimisht qëndresën e armikut në lartësitë dominuese mbi qytetin e Priepoljes, si dhe gjatë rrugës Priepolje-Priboj, e mbyllën atë në qytet dhe më 11 janar 1945 e çliruan. Gjatë luftimeve në Priepolje armiku la të vrarë dhe shumë materiale luftarake. Me 12 janar forcat e Divizionit morën Prikojin duke çliruar kështu gjithë luginën e Limit dhe dolën në kufijtë e Bosnjës.

Me luftimet në Sanxhak, Maqedoni, Kosovë e Rrafshin e Dukagjinit Div. V S kishte plotësoi me sukses detyrat e caktuara, shkruajti një faqe të lavdishme në historinë e UNÇSH; duke dëshmuar dashuri të zjarrtë ndaj Atdheun e kombit, tregues ky i frymës atifashiste, si pjesë e kontributit të popullit tonë në Luftën e Dytë Botërore. Div. V S, mbasi qëndroi për disa kohë në Senicë, Mitrovicë, Gjilan e Gostivar u kthye në atdhe me lavdinë e fitores. Ai përshkroi një rrugë luftarake 400 km të gjatë, duke zhvilluar luftime intensive kundër një armiku me epërsi numerike, si në forca dhe në mjete, duke lënë në fushën e betejës 177 dëshmorë. Në prill të vitit 1945 Divizioni u riorganizua dhe më 9 dhjetor 1945 u vendos në Elbasan.

Veprimtaria luftarake e Divizionit VI S

Pas çlirimit të Shkodrës kaluan kufirin shtetëror dhe u vunë në ndjekje të armikut në drejtimin Podgoricë-Lieva- Reka forcat e Div. VI S. Nga Hani i Hotit në drejtim të Tuzit e gjer në majën Gjeroricës në drejtim të Lieva-Rekas të rreshtuara, nga e majta në djathtë, u vendosën forcat e Br. XXII, VIII, VII dhe VI S duke patur përballë forcat e Divizionit 81 Granatier dhe pjesërisht forcat e Divizionit 22 Granatier. Kështu zëvendësuan Br. IX S të Div. III Jugosllav, e cila kaloi në Matashevo.

Në zbatim të urdhërit të 7 dhjetor 1944 të dhënë nga vendkomanda me qendër në zonën Pikale-Triepshe, më 9 dhjetor forcat e Div. VI S u hodhën në mësymje në të gjithë frontin. Në interes të zbatimit të kësaj detyre forcat e Div. VI S nga data 9 deri 13 dhjetor 1944 kaluan me mësymje duke vepruar në një terren mjaft të vështirë e të fortifikuar dhe e detyruan armikun të braktisë zonat në periferi

dhe të tërhiqet. Qysh në ditët e para të veprimeve luftarake forcat partizane shqiptare në Mal të Zi ndeshën në pengesa serioze e arbitrare nga shtabet e ushtrisë jugosllave. Nga data 8 dhjetor 1944 forcat e Br. XXII S zhvilluan luftime të ashpra në sektorin Pikale- Helenica. Më 11 dhjetor ato u hodhën në sulm me gjithë sektorin e tyre Deçic-Tuz, i vunë përpara hitlerianët dhe i detyruan ata të largohen nga kalaja e Deçicit, luftime që vazhduan 15 orë pa ndërprerje dhe u kthyen në përleshje trup më trup. Pas kësaj forcat e Br. XXII S vazhduan sulmin mbi Tuz dhe më 14 dhjetor në mëngjes e çliruan.

Më 15 dhjetor 1944, forcat e Br. XXII S u hodhën në sulm për çlirimin e Podgoricës dhe në mbrëmjen e 19 dhjetorit me luftime i detyruan gjermanët të tërhiqen në panik. Më datën 12 dhjetor një pjesë e forcave të Br. VIII S, sulmuan dhe i detyruan të tërhiqen forcat gjermane midis fshatrave Kërzhanjë e Mamce, e njëjta situatë u zhvillua edhe në drejtimin mbi Berskut ku më 13-14 dhjetor forcat e Br. VII S sulmuan kodrat në të majtë të Lieva-Rekas dhe gjatë 12 orë sulmi të pandërprerë i shkaktuan armikut 30 vrarë dhe mjaft të plagosur. Br. VI S prej katundit Venush (pa bat. 3) goditi trupat gjermanë në sektorin pranë rrugës automobilistike Lieva-Reka-Verusha.

Më 16-22 dhjetor 1944, Br. VI dhe VIII S vazhduan mësymjet në drejtimin: Verushë-Jabllane-Bersh duke i detyruan gjermanët të braktisin pozicionet dhe të lënë më shumë se 280 të vrarë dhe shumë të plagosur. Prej 20-25 dhjetor 1944 Br. VII S zhvilloi luftime në kodrat e Kosarit, në Zllaticë dhe në katundin Bioce. Gjatë këtyre ditëve në sektorin e Br. VII S armiku la 108 të vrarë dhe 66 robër. Më 26 dhjetor 1044, grupimi i forcave gjermane në Malit të Zi, për t'i shpëtuar rrethimit e asgjësimit të plotë, u tërhoq me shpejtësi në drejtim të Kolashinit.

Karakteristikat e kësaj faze, e cila zgjati 30 ditë, ishte vazhdueshmëria e pandërprerë e veprimeve luftarake, ndërimi i shpejtë i situatës, kalimi nga një lloj luftimi në tjetrin dhe anasjelltas, zhvillimi i mësymjes në përgjithësi nga poshtë lart në terren malor e të zhveshur, manovra e shpejtë nga një drejtim në tjetrin, mungesa e bashkëveprimit me repartet e ushtrisë jugosllave, burrëria, qëndrueshmëria dhe heroizmi i partizanëve të Div. VI S. Të gjitha këto ngjallën një respekt të thellë në popullsinë e Malit të Zi.

Veprimet luftarake të Div. VI S më tej u pasuan në periudhën nga 1 deri 26 janar 1945, koha që forcat e divizionit dolën nga kufijtë e Malit të Zi dhe derisa ato arritën në sektorin e Plevujës e të Rudos duke bashkëvepruar ngushtë me forcat e Div. V S. Më 31 dhjetor 1944 shtabi i Div VI S u vuri detyrë shtabeve të brigadave të viheshin menjëherë në ndjekje, të mos shkëputnin kontaktin, të sulmonin e asgjesonin kolonat armike dhe të mos lejonin që gjatë tërheqjes nazistët gjermanë të digjnin e shkatërronin vendin në dy drejtime: Br. VI, VIII dhe XXII S organizuan ndjekjen dhe mësymjen në drejtimin: Lieva-Reka-Matashevo-Andrejevica-Kolashiu-Plevje. Br. VII S plotësoi po këtë detyrë duke ndjekur drejtimin: Lieva-Reka-Matashevo-Andrejevica-Biellopolje-Plevj, ku dinamika e zhvillimeve luftarake u vendos në tokat e Sanxhakut. Më 1 janar 1945 brigadat u vunë në lëvizje, më 2 janar nga marshimi kaluan në sulm në rajonet e Kolashimit e të Matashevos shpartalluan armikun çliruan të dyja këto qendra dhe arritën në portat Majkovicit. Radioja e ushtrisë jugosllave u detyrua të pohonte duke njoftuar: "Njësit shqiptare e jugosllave, janë duke arritur në portat e Majkovicit mbasi e çliruan Kolashinin dhe Matashevën, ku luftimet vazhdojnë të jenë të ashpra". Midis datave 3-8 janar 1945 Br. VII S kryeu një varg sulmesh me drejtimin Borane-Shahovic, ndërsa Br. VIII, XXII S sulmuan trupat gjermane në rajonet Majkovac-Shahovic. Më 11-12 janar 1945, forcat e Div. VI S duke vazhduar marshimin dhe sulmet e pa ndërprera, arritën në rajonin e Plevejës e të Rudos dhe dolën kështu në kufijtë e Bosnjës Jugore, ku deri më 16 janar 1945 zhvilluan mjaft luftime dhe u vunë në gatishmëri për të marrë detyrë të re. Gjatë kësaj faze Div. VI S ndoqi armikun këmba-këmbës në të gjithë territorin e Sanxhakut duke vepruar në krahë të majtë të Div. VI S, përshkroi me luftime tërë Sanxhakun dhe në gjysmë të janarit u fut në Bosnjën Jugore.

Populli shqiptar kurrë nuk e ka kursyer ndihmën e tij për këdo e në mënyrë të veçantë për fqinjët në shekuj, e në mënyrë të vecantë gjatë Luftës së Dytë Botërore, por dhe sot në luftën kundrë terorrizmit ndërkombëtar, duke u rreshtuar si përherë në krahun e përparimit, progresit e të fitimtarëve

Div. VI S fillon fazën e tretë më 17 janar 1945, kur shtabi i tij lëviz forcat në drejtim të Vishegradit dhe vazhdon deri në çlirimin e tij më 14 shkurt 1945. Hitlerianët e konsideronin Vishegradin si qendrën më të mirë e më të rëndësishme për t'u grumbulluar dhe pastaj për t'u tërhequr ku ishin përqëndruar rreth 15.000 vetë të cilat sipas mendimit të shtabit hitlerian përbënin një forcë të aftë për t'u rezistuar trupave tona. Më 18 janar 1945 të gjitha forcat e Div. VI S u vunë në lëvizje dhe më 19 janar u hodhën në mësymje dhe deri më 25 janar në të gjitha drejtimet u zhvilluan luftime të përgjakshme. Në pesë ditë armiku pati 489 të vrarë dhe 1045 të plagosur, kurse nga forcat tona ranë 27 dëshmorë dhe u plagosën 28 vetë duke dalë në vijën Dobrun-Zllatnik-Drinsko e duke ngushtuar darën rreth Vishegradit. Nga 25 janari deri më 2 shkurt vazhduan luftime të ashpra sidomos në sektorin e Br. VIII S për marrjen e Vishegradit ku e detyruan gjermanin të mbyllet në qytet, më vonë të hidhej përtej lumit Drino. Në mëngjesin e 14 shkurtit 1945 u çlirua Vishegradi. Nga 19 janari deri më 14 shkurt 1945 armiku pati 756 të vrarë dhe 1795 të plagosur, ndërsa nga forcat tona 51 partizanë dëshmorë dhe 66 u plagosën, kursë jugosllavë 6 u vranë dhe 18 u plagosën. Br. V e Sanxhakut tregoi inaktivitet të madh, ndërsa përgjithësisht forcat jugosllave e prenë luftën ditë më parë qysh në orën 17.00 të datës 5 shkurt 1945 dhe nuk iu dhanë as municion forcave të Div. VI S.

Çlirimi i qytetit të Vishegradit për Div. VI S shënon mbarimin e të gjitha veprimeve luftarake të suksesshme 76 ditore në tokat e Jugosllavisë ku armiku pati gjithsej "3758 ushtarë e oficerë të plagosur". Veprimet luftarake të Br. XXVII S në Ulqin e Tivar, ndonëse vepronte në mënyrë të pavarur, janë të lidhura me fazën e parë të veprimeve luftarake të Div. VI S në tokat e Jugosllavisë kundër armikut të përbashkët.

Div. V dhe VI S pas çlirimit të Vishegradit u urdhëruan nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë shqiptare të ktheheshin përsëri në Kosovë e Maqedoni me detyrë që të ndihmonin në likuidimin e bandave reaksionare në këto krahina e të bënin sqarimin e nevojshëm për marrëdhëniet midis tyre. Nga 1-5 mars 1945 filluan lëvizjen duke ndjekur intinerarin nga Rudo e Vishegrad në Priboj, Sjenicë e Mitrovicë. Nga 10-12 mars 1945, pas një marshimi të sforcuar hynë në territoret e Kosovës dhe të Maqedonisë. Nga marsi deri në gusht të vitit 1945, forcat e divizioneve tona zhvilluan operacione të suksesshme kundër bandave reaksionare e çetnike në Ramanishte, Kalinie, Vasiljeviç, Brazhdë, Velikareka, Sardesh, Kacado, Brandas, Llazan, Mexher, Cerminë, Cecilja, Esticë, Rokanicë, Strugë etj., si dhe bërë sqarimet e nevojshme me popullatën e këtyre zonave gjë e cila nuk u pëlqente jugosllavëve.

Populli shqiptar kurrë nuk e ka kursyer ndihmën e tij për këdo e në mënyrë të veçantë për fqinjët në shekuj, e në mënyrë të vecantë gjatë Luftës së Dytë Botërore, por dhe sot në kuadrin e angazhimit për të luftuar terorrizmin ndërkombëtar, duke u rreshtuar si përherë në krahun e përparimit, progresit e të fitimtarëve.

Samiti i vitit 1990: pikë kthese në marrëdhëniet "Lindje- Perëndim"

Rënia e Murit të Berlinit në vitin 1989 çoi në ndryshime radikale ndaj sigurisë në Evropë. Që në fillim të korrikut të vitit 1990, udhëheqësit e NATO-s diskutuan ndikimin e kësaj ngjarje historike në Samitin e Londrës, që përshkroi propozimet për zhvillimin e bashkëpunimit me vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. "…..Lufta e Ftohtë i takon historisë, Aleanca jonë po shkon nga konfrontimi në bashkëpunim", ka deklaruar Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Manfred Verner në komentet e tij të hapjes.

Teksti i procesverbalit të Samitit të NATO-s të Londrës i vitit 1990

Dokumenti fjalë për fjalë i i Samitit të Londrës (C-VR (90) 36), është miratuar për deklasifikim dhe zbulim publik. Ai iu dha qasje të drejtpërdrejtë në diskutime Kryetarëve të Shteteve dhe Qeverive, gjatë të cilave ata morën aksione në implikime të mëdha që ishin për sigurinë e vendeve anëtare të NATO-s, për kontinentin evropian si një i tërë dhe më gjerë.

Dokumenti tregon qëndrueshmërinë e qasjes së NATO-s drejt Lindjes që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Diskutimet u përqëndruan kryesisht në çarmatimin dhe marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore. Udhëheqësit e NATO-s parashikuan gjithashtu bashkëpunimin përmes aktiviteteve politike dhe ushtarake, si edhe nëpërmjet krijimit të lidhjeve të rregullta diplomatike me këto vende. Ishte një perceptim i qartë që, siç deklaroi presidenti amerikan George Bush drejtuar Këshillit, "…Ne duhet të ndërtojmë një aleancë për të transformuar Evropën e re të shekullit të 21-të". Në të njëjtën mënyrë dhe homologja i tij britanike, kryeministrja Margaret Thatcher tha se "sinjali ynë nga ky takim duhet të vazhdojë të jetë vendosmëria në mbrojtje, vendosmëria dhe uniteti në mbrojtje, së bashku me gatishmërinë për t'i zgjatur dorën e miqësisë Evropës Lindore dhe Bashkimit Sovjetik".

Zgjerimi i "dorës së miqësisë"

Në Londër, NATO i shtriu "dorën e miqësisë" ish vendeve të Paktit të Varshavës, duke i ftuar ata për të formuar një marrëdhënie të re me NATO-n. Dokumenti fjalë për fjalë reflekton dëshirën e NATO-s për të qenë përfshirëse e Europës Qendrore dhe Lindore pa izolimin e Bashkimit Sovjetik. Presidenti francez François Mitterrand tha se ",…..ne duhet të marrim parasysh interesat e të gjithë vendeve evropiane, duke përfshirë edhe ato të cilat janë ende anëtare të Paktit të Varshavës dhe……Unë nuk kam asnjë hezitim duke e thënë këtë edhe për Bashkimin Sovjetik".

Kur liderët e 28 vendeve të NATO-s u takuan në Uells këtë vit, ata u kthyen përsëri, Samitit të fundit të NATO-s të mbajtur në Mbretërinë e Bashkuar. Deklarata e Uellsit e Marrëveshjes Transatlantike, në Samitin e Londrës të vitit 1990 thekson si momentin kyç në histori, ku NATO u përshtat për të përmbushur realitetet e kohës.

Themelet e një marrëdhënie të re

Një vit pas Samitit të vitit 1990, NATO, Bashkimi Sovjetik dhe 11 vende të tjera formuan Këshillin e Atlantikut të Veriut për bashkëpunim (NACC). Ky forum hapi teren të ri duke bërë të mundur konsultimin shumëkombësh politik dhe bashkëpunimin, si dhe ndërtimin e besimit midis NATO-s dhe këtyre vendeve. Fillimisht, NACC u përqëndrua në shqetësime të mbetura të sigurisë të Luftës së Ftohtë, por meqë bashkëpunimi u zhvillua, këshilli çoi në krijimin e Partneritetit për Paqe të NATO-s, një program i kooperimit bashkëpunues dhe praktik, i cili u nënshkrua nga Rusia dhe dhjetra vende të tjera të ish-Bashkimit Sovjetik dhe vende të Paktit të Varshavës në vitin 1994. Samiti në fund të fundit përfaqësoi themelin e një bashkëpunimi të ri dhe të modernizuar me NATO-n. Dokumenti hedh dritë mbi gjuhën, politikën dhe planifikimin e anëtarëve të NATO-s gjatë kësaj kohe në këtë pikë kthese historike.

Mimoza Golikja
Nato.int

NATO shqyrton bashkëpunimin me Mongolinë përmes shkencës

Që kur Mongolia u bë një partner global i NATO-s, më pak se dy vjet më parë, Programi Shkenca për Paqen dhe Sigurinë (SPS), e NATO-s, ka mbështetur një numër të projekteve në fushën e shkencës dhe inovacionit. Veprimtaria për rishikimin e këtyre përpjekjeve dhe për të identifikuar rrugët për të zgjeruar më tej bashkëpunimin, u zhvillua në Ulaanbaatar të Mongolisë më 27 nëntor 2014.

Qëllimet e përbashkëta

E para e këtyre projekteve, e titulluar "IT mbështet Akademinë e Shkencave të Mongolisë", ishte projektuar për të forcuar aftësinë e Akademisë në fushën e mbrojtjes kibernetike. Filluar në vitin 2012, ishte përpjekja e parë bashkëpunuese midis Aleancës dhe Mongolisë përmes Programit SPS. Agjencia e Komunikimeve dhe Informacionit e NATO-s, (Ncia), bashkëpunoi me Akademinë për të kryer projektin. Projekti shënoi një kapitull të ri të rëndësishëm në marrëdhëniet dhe ofroi një platformë për dialog strategjik dhe bashkëpunim praktik në sfidat e përbashkëta.

"Ky bashkëpunim është një hap i rëndësishëm në zhvillimin e aftësive të Akademisë së Shkencave për të mbrojtur rrjetet e veta të IT-së dhe gjithashtu do të ndihmojë për të zhvilluar kapacitetet e institucioneve të tjera qeveritare të Mongolisë në të ardhmenen" ,tha Dr. Profesor Batbold Enkhtuvshin, President i Akademia së Shkencave të Mongolisë.

Delegatët shqyrtuan edhe një projekt për të mbështetur krijimin e një gjeobaze të dhënash për restaurimin e ish-vendeve ushtarake. Kjo paraqet një hap të rëndësishëm, e parë në procesin e rehabilitimit të tokës së degraduar. Agjencia e Mjedisit sllovake dhe Instituti i Gjeoekologjisë të Akademisë së Shkencave të Mongolisë po e udhëheqin këtë projekt i cili pas gati dy vjetësh ka arritur tashmë rezultatet e përkohshme shumë mbresëlënëse. Projekti do të vazhdojë edhe për dy vjet.

Partner global

Mongolia gjithashtu është duke marrë pjesë në projektin e SPS të titulluar "Perceptimet Globale të NATO-s, Pamje të rajonit të Azi-Paqësorit". Në këtë përpjekje të përbashkët, Instituti për Studime Strategjike i Mongolisë, së bashku me shkencëtarët nga Australia, Estonia, Japonia, Republikën e Koresë dhe Zelanda e Re, do të analizojnë imazhet dhe perceptimet e NATO-s si një aktor global i sigurisë në rajonin e Azi-Paqësorit. Dr. Munkthur, i Institutit theksoi se projekti përshtatet shumë mirë me politikën e jashtme të Mongolisë dhe plotëson përpjekjet për një rol gjithnjë e më potencialisht aktiv të vendit të tij në rajon.

Këshilltari i lartë i Divizionit për Sfidat e Sigurisë në Rritje të NATO-s, Michael Gali, tha se "Suksesi i këtyre projekteve dhe perspektivat për intensifikimin e bashkëpunimit Mongoli-SPS, përveç bashkëpunimit të Aleancës në zona të tjera, thellojnë vazhdimisht dhe zgjerojnë partneritetin tonë me Mongolinë".

Veprimtaria u organizua nga Ministria e Punëve të Jashtme të Mongolisë dhe Akademia e Shkencave dhe e mbështetur nga Programi i SPS i NATO-s.

Më vonë, zëvendës ministri i Mbrojtjes, Avirmed Battur, theksoi dëshirën e tij për të ndërtuar mbi bashkëpunimin e suksesshëm deri më tani dhe për të përmirësuar infrastrukturën e IT të Ministrisë së Mbrojtjes të Mongolisë dhe Forcave të Armatosura nëpërmjet bashkëpunimit të Mongolisë përforcuar me Programin SPS.

Le të qeshim pak për Vitin e Ri

Kartolina për Vitin e Ri

"I dashur babagjysh, jam një djalë jetim. Të lutem më ndihmo me 10.000 lekë që të blej dhe unë lodra për Vitin e Ri". Kartolinën e dërgon në postë. Një punonjëse e postës e shikon kartolinën e djalit të vogël dhe, e mbushur me keqardhje, njofton shoqet e saj për atë çka kërkonte ai. Të gjithë punonjëset e postës vendosin ta ndihmojnë atë dhe mbledhin një shumë prej 50.000 lekë. Ato ia dërgojnë djalit të vogël me postë. Pas disa ditësh në postë erdhi një kartolinë tjetër, ku djali i vogël i kthente përgjigje babagjyshit të Vitit të Ri:

"I dashur babagjysh, falemnderit që ju përgjigje kërkesës time dhe më dërgove 10.000 lekë, por po të them se unë mora vetëm 5.000 lekë. Siç duket gjysmën mi mbajtën ato hajdutet që punojnë në postë".

Do hidhem nga çatia

Ai: Para një javë desha të vras veten.
Ajo: Po si?
Ai: Do hidhesha nga çatia.
Ajo: Po ç'të bëri të ndryshoje mendje?
Ai: Kisha frikë të hipja në çati se mos bija.

Puthja e parë

- A të kujtohet i dashur, në këtë park ma ke vjedhur puthjen e parë? - i thotë gruaja burrit.
- Po si nuk më kujtohet, e dashur, - ia kthen burri, - Për shkak të asaj vjedhje ende jam në burg.

Plaku dhe mjeku

Një plak shkon për t'u vizituar te mjeku.
Mjeku: Çfarë halli të ka sjellë?
Plaku: Po ja, më dhëmb këmba e majtë.
Mjeku: Sa vjeç jeni?
Plaku: 87.
Mjeku: Po është normal, në këtë moshë do të keni ndonjë shqetësim të vogël, mos harroni se jeni 87 vjeç.
Plaku: 87 vjeçe është edhe këmba e djathtë doktor, por nuk me ka sjell kurrë shqetësime.

Dialog

Ushtari ishte pirë dhe ishte bërë tapë. Teksa kthehej në kazermw, te dera i del komandanti.
- O, kamandant, me falni, po a mund të futem?- i thotë ushtari i dehur.
- Mirë, mirë futuni, - ia kthen komandanti, - po pa zhurmë dhe në rresht për një, jo kështu grumbull!

Mbylle gojën

Dentisti i thoshte pacientes:
- Zonjë, hapeni gojën, ju lutem!
- Falemnderit, - ia kthen pacientja.
- Përse më falënderoni?- e pyet ajo.
- Sepse im shoq më thotë gjithmonë "Mbylle gojën!"

Nuk merrem vesh me burrin

Semihaja i qahej shoqes:
- S'kam çfarë të bëj, vërtet që nuk kuptohem dot me burrin.
- Pse, çfarë ndodh?- i thotë shoqja.
- Po ja, i thashë që s'dua të shoh më.
- Po ai çfarë tha?
- Thjesht, fiku dritën e dhomës dhe u shtri...

Biondja

- Të lutem, më jep një fustan me mëngë zhapone, - i drejtohet me mirësjellje një bionde shitëses së dyqanit.
Shitësja, pasi rrëmon në sirtarët e vitrinave gjen një sipas numrit të blerëses dhe ia jep për ta provuar.
Pas provës në këndin e caktuar, blerësja simpatike del nxitimthi dhe i thotë shitëses:
- Po ky fustani qënka pa mëngë!
- Po pra, - i thotë shitësja, - është me mëngë zhapone.
- Që është me mëngë zhapone e mora vesh, po mëngët ku i ka?- vazhdon me të sajën vajza biionde...

Përgatiti: Agron Goga
Kartolina për Vitin e Ri

SKICË

Atë ditë në prag të Viti të Ri

Bënte ftohtë i hidhur dhjetori. Kodrat përreth Athinës ishin mbuluar me borë. Era, që s'dihej nga vinte, të priste si brisk. Prag Viti i Ri. Athina llamburiste. Dyqanet të tejmbushura me mallra. Gjallëri e pazakontë dhe pse ishte aq ftohtë. Në kryqëzimin e një udhe, në Halandri, pronari im ndali makinën, në pritje të semaforit jeshil. Befas, te xhami u dritares u zgjat një dorë lypësi. Ishte një fëmijë 10-11 vjeçar që në dorë mbante një gotë kauçuku.

-Ju lutem zotërinjë, më ndihmoni, - foli fëmija dhe uli kokën. Kërkonte diçka për të kaluar Vitin e Ri.

Më bëri përshtypje sjellja e tij delikate dhe koka e ulur. Nga gjuha e kuptova, ishte nga vendi im. Me sa dukej i vinte rëndë për atë që po bënte. Ndryshonte nga ata fëmijët, që ishin kthyer në lypësa profesionistë.

- Nga jeni?- e pyes në shqip.

Ai nuk e priste që dikush t'i fliste në gjuhën e tij. Uli më shumë kokën dhe tërhoqi paksa dorën. Nuk donte që dorën e tij të zgjatur ta shihte një bashkëatdhetar i tij. Gota e kauçukut i dridhej në dorën e plasaritur nga të ftohtit. Ashtu kokëulur u përgjigj:

-Jam me babain, por ai ka thyer këmbën dhe ka kohë që nuk punon. Nuk më ka nxjerrë ai në udhë, por s'ka tjetër kush të punojë, - sytë iu mbushën me lotë dhe duke ngritur pak zërin, sikur donte të mbronte familjen e tij, shtoi: - Babai im është më i miri në botë…

- Po nëna nuk punon? Për një çast ai u ndrydh.

- Nëna…më ka vdekur… - dhe ia plasi të qarit.

Semafori ndezi dritën jeshile. Veç pronarit zgjata edhe unë dorën për të ndihmuar atë djalë fatkeq dhe munda t'i përkëdhelja fare pak flokët kaçurel…

- Dukej djalë i mirë? - tha pronari kur nisi makinën, - por, lypës.

- Nuk ishte lypës, - ia ktheva, - ishte një fëmijë fatkeq, i rritur para kohe jo vetëm për punë, por dhe në mendime. Shpesh jeta është e padrejtë, apo jo miku im, - dhe pashë në sy pronarin grek. Ai nuk foli, por nga sytë që iu picërruan kuptova se po ndjente më tepër se keqardhje për atë djalë të vogël që lam pas në udhëkryqin e rrugës në Halandri…

ALBERT ZHOLI

Karikatura nga Kosta Raka

Jam unë komandanti!



Une i hodha pepinot ne det

Faleminderit familja jonë e madhe!

Koncert festiv i fëmijëve të ushtarakëve të FA

Pranverë ngjyrash, që kori i fëmijëve derdh në skenë si asnjëherë tjetër në këtë fundviti. Kanë ardhur në këtë festë prindër, nëna dhe baballarë, gjyshe dhe gjyshër, motra dhe vëllezër dhe shumë, shumë fëmijë...Janë fëmijë të ushtarakëve që festojnë. "Ata, falë kujdesit të Ministrisë së Mbrojtjes kanë privilegjin që përveç angazhimit në shkollë të ndjekin edhe kurse të ndryshme trajnimi pranë Qendrës së Kulturës të Forcave të Armatosura, në QKMBMMSHP", tha në fjalën e saj të përshëndetjes drejtoresha e kësaj qendre znj. Mirela Roshi. Fëmijët e ushtarakëve që ndjekin këto kurse gjatë gjithë vitit janë të shumtë. Ata vijnë dhe trajnohen me plot dëshirë, për të zhvilluar më tej talentin e tyre, në fusha të ndryshme të artit, muzikës, pikturës, arteve marciale etj. Por sot është festa e tyre, është festa e fundvitit dhe fëmijët janë në një rol tjetër përpara njerëzve të tyre të dashur. Ata sot me këngët, vallet, recitimet, numrat e cirkut, e bëjnë më të gëzueshme këtë natë feste. Kanë një program festiv, tërësisht të krijuar vetë, program që kanë zgjedhur ta hapin me këngën "Merry Christmas". Pastaj në skenë vijnë recituesit e vegjël, me recitimet e tyre më të ndjeshme dhe me vjersha të përzgjedhura me kujdes. Sërish kori i fëmijëve me këngën e "Vitit të Ri", sërish tinguj e nota që përcillen nga zërat e ëmbël dhe ne ndërkohë, ndjejmë se tanimë festa ka filluar...

Dalëngadalë ky vit po kthen fletët e fundit të kalendarit. "Faleminderit për gjithçka keni bërë për ne prindër e mësues të dashur. Faleminderit edhe stafit të Qendrës së Kulturës, Medies, Botimeve dhe Shtëpive të Pushimit të Ministrisë së Mbrojtjes, që na bëjnë të ndjehemi si një familje e madhe si në shtëpinë tonë", falënderon njëri prej moderatorëve në emër të të gjithë fëmijëve.

Por sot në këtë mbrëmje të bukur festive, të fëmijëve nuk mungojnë as miqtë dhe as të ftuarit e tyre, ata janë të shumtë, prandaj për të nderuar të ftuarit, ata kanë sjellë në program, për të kërcyer një valle në këtë skenë festive, grupin e valltarëve të Qendrës Kombëtare Kulturore të Fëmijëve edhe një grup fëmijësh të liceut artistik që të përshëndesë programin, madje edhe një flautiste. Skenës nuk i mungojnë as artistët e cirkut të Tiranës, të cilët gjithashtu me interpretimin e tyre të guximshëm i mahnitën të gjithë.

Janë të dashur për të pranishmit këngëtarët e njohur si Redon Makashi, i cili solli për këtë festë këngën "Kartolina", që jo vetëm interpretimi i bukur por edhe vetë fjalët e këngës të bëjnë të jetosh me çastet festive. Momente të bukura dhe prekëse kur ndërkohë moderatorja artikulon para të pranishmëve një falënderim të veçantë për "për të gjithë ushtarakët tanë që shërbejnë në misionet paqeruajtëse jashtë atdheut. Ata do të dëshironin të ishin sonte këtu në sallë, por angazhimet që kanë në këto misione e bëjnë të pamundur praninë e tyre në këtë mbrëmje festive", - thotë ajo.

Çaste të bukura urimi, çaste të bukura feste, sy që shkëlqejnë nga lot lumturie tek këndohet kënga e bukur për atdheun e shtrenjtë. Misionarët tanë të paqes i përshëndet një këngëtar tjetër i mirënjohur, Kozma Dushi, me kolonën zanore të filmit "Kur xhirohej një film". Festa arrin kulmin kur në skenë hyn plaku i Vitit të Vjetër. Janë orët e fundit të pranisë së tij me këta fëmijë të mrekullueshëm që i kanë "dhuruar gjithçka të bukur që kanë bërë së bashku". Respekti dhe falënderimi i fëmijëve është i sinqertë për "Babagjyshin e Vitit të Vjetër", për çdo ditë të bukur që u ka sjellë.

Dhe festa nuk ka të mbaruar. Dhuratat janë surpriza që ia shtojnë bukurinë festës, së bashku me ardhjen në skenë të Vitit të Ri, i cili i uron fëmijët për një vit më të lumtur e më të begatë.

Gëzuar!

MIMOZA GOLIKJA

Fotot: Elvin Hasanaj